



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

***Grabitjet dhe vjedhjet e rënda në pjesën perëndimore
të Republikës së Maqedonisë të Veriut në periudhën
kohore 2013-2019***

Emri: ERA POCESTA

Programi studimor: E DREJTA PENALE

Fakulteti: Fakulteti i Drejtësisë

Data e fillimit të studimeve: 2018

Deri te: Këshilli Mësimor – Shkencor

Fakulteti i Drejtësisë

Universiteti i Evropës Juglindore

KËRKESË

Bazuar në rregulloren në fuqi për studime posdiplomike, për caktimin e tezës së masterit pranë Universitetit të Evropës Juglindore, unë Era Pocesta, studente në studime posdiplomike – Master, në programin studimor: E DREJTA PENALE, KËRKOJ nga Këshilli Mësimor - Shkencor i Fakultetit të Drejtësisë që konform akteve normative të Universitetit – Fakultetit Juridik, të SHQYRTOHET dhe APROVOHET kërkesa ime për lejimin e tezës së magistraturës, respektivisht të më mundësohet fillimi i hulumtimit dhe kërkimit shkencor për temën e propozuar, me titull:

“Grabitjet dhe vjedhjet e rënda në territorin e pjesës perëndimore të Republikës së Maqedonisë të Veriut në periudhën kohore 2013 – 2019”

Qasja teorike dhe praktike e temës së propozuar është bërë në bashkëpunim dhe konsultim me mentoren time: Prof. Ascc. Dr. Besa Arifi.

Shpresoj dhe besoj që kërkesa ime do të shqyrtohet dhe do aprovohet në mbledhjen e radhës të Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakultetit Juridik dhe do të pranohet.

Ju falënderoj për mirëkuptim.

Mentore:

Prof.Asoc.Dr. Besa Arifi

Kandidate:

Era Pocesta

Titulli punues i temës : “Veprat penale - Grabitjet dhe vjedhjet e rënda në pjesën perëndimore të Republikës së Maqedonisë Veriore në periudhën kohore 2013-2019”

Работен наслов на темата ’ Кривични дела – Разбојништва и тешки крајби на западниот дел од Република Северна Македонија во периодот од 2013 – 2019.

Përkthimi i titullit punues në anglisht: “Criminal Offenses- robberies and thefts in the **ëestern** part of the Republic of North Macedonia in the period 2013-2019”

PËRMBAJTJA

| | |
|------------------------------------|---|
| 1. Lënda | e |
| hulumtimit..... | |
| 2. Qëllimet | e |
| hulumtimit..... | |
| 3. Hipotezat..... | |
| 4. Metodologjia e hulumtimit | |
| 5. Rëndësia e punimit | |

Hyrje.....

KAPITULLI PARË

KARAKTERISTIKAT LIGJORO PENALE TË VEPRAVE PENALE – GRABITJET DHE VJEDHJET E RËNDA

| | |
|---|--|
| 1. Veprat penale kundër pronës..... | |
| 2.Karakteristikat ligjoro penale të veprave penale – grabitje dhe vjedhjet e rënda..... | |
| 2.1. Rëndësia ligjore e veprës..... | |
| 2.2.Subjekti aktiv – kryersi i veprës..... | |
| 2.3.Subjekti pasiv – viktima..... | |
| 2.4. Objekt i mbrojtjes..... | |
| 2.5.Ana subjektive e veprës..... | |
| 2.6.Bashkëpjesëmarrje dhe bashkëkryerje..... | |
| 2.7.Nxitje (inkurajim) dhe dhënie ndihme në kryerjen e veprës..... | |

KAPITULLI I DYTË

KARAKTERISTIKAT KRIMINOLOGJIKE TË VEPRAVE PENALE –GRABITJET DHE VJEDHJET E RËNDA

1. Karakteristikat etiologjike.....
- 1.1. Faktorët dhe shkaqet për dukurinë e paraqitjes së delikteve të pronës, me qasje të veçantë dhe përkushtim të grabitjeve dhe vjedhjeve të rënda.....
2. Karakteristikat fenomenologjike të veprave penale – grabitjet dhe vjedhjet e rënda.....

KAPITULLI I TRETË

KARAKTERISTIKAT KRIMINALISTIKE TË VEPRAVE PENALE – GRABITJET DHE VJEDHJET E RËNDA, ME SHQYRTIM TË VEÇANTË TË KËTYRE VEPRAVE TË KRYERA NË PJESËN PERËNDIMORE TË RMV 2013-2019

1. Mënyra e kryerjes të veprave penale - grabitje dhe vjedhje të rënda

- 1.1. Mjetet që përdoren për kryerjen e grabitjeve dhe vjedhjeve të rënda (instrumentum operandi).....
- 1.2. Mënyra e kryerjes së grabitjeve, të kryera në pjesën perëndimore të RMV gjatë periudhës kohore 2013-2019.....
- 1.3. Mënyra e kryerjes së vjedhjeve të rënda, të kryera në pjesën perëndimore të RMV gjatë periudhës kohore 2013-2019.....

2.Gjurmët

- 2.1Gjurmët nga mjetet e përdorura.....
- 2.1.1. Llojet e mjeteve.....
- 2.1.2.Llojet e gjurmeve nga mjetet e përdorura.....
- 2.1.3. Fiksimi i gjurmëve nga mjetet e përdorura.....
3. Personaliteti i kryerësit.....

4.Viktima.....

KAPITULLI I KATËRT

PROCESUIMI KRIMINALISTIK PAS ZBULIMIT TË VEPRAVE PENALE – GRABITJET DHE VJEDHJET E RËNDA, ME SHQYRTIM (AKCENT-TRAJTIM) TË VEÇANTË – TË POSAÇEM TË KËTYRE VEPRAVE TË KRYERA NË PJESËN PERËNDIMORE TË RMV 2013-2019 DHE PARANDALIMI I TYRE

- 1.Mënyra e zbulimit të ekzistimit të veprës penale – grabitje dhe vjedhje të rëndë.....
2. Parandalimi tek veprat penale – grabitje dhe vjedhje e rëndë.....
3. Masat preventive që i ndërmer Ministria e Punëve të brendshme në RMV.....
4. Masat preventive të ndërmarra nga ana e qytetarëve.....

PËRFUNDIMI.....

BIBLIOGRAFIA.....

1. Lënda e hulumtimit.

Kjo temë magjistrature trajton dhe analizon fenomenin e vjedhjes në tërësinë e elementëve të saj përbërës në Republikën e Maqedonisë, specifikisht në periudhën kohore nga viti 2013-2019, vite të cilat mund të cilësohen si periudhë e fundit aktuale dhe që vlejné për t'u trajtuar nga ana jonë për të përcaktuar situatën e kriminalitetit të një vendi. Gjithashtu punimi trajton në një pjesë të rëndësishme të tij, edhe faktorët kriminologjikë që ndikojné dukshëm në shfaqjen e kësaj veprimtarie kriminale duke pasqyruar tendencat e fundit lidhur me të rinjtë, si autorë të këtyre krimeve në Republikën e Maqedonisë dhe njëkohësisht jep rekomandime për përmirësimin e tyre.

Hulumtimi do të zhvillohet vetëm në zonën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si pjesë e rëndësishme e vendeve të Evropës Juglindore, e cila banohet kryesisht me shqiptarë. Studimi do tëmbështetet në kombinimin e mënyrave hulumtuese sasiore dhe cilësore, si dhe me analizën e të dhënave kryesore, por edhe të atyre dytësore.

2. Qëllimet e hulumtimit.

Në dekadat e fundit, kudo në botë është rritur shkalla e kriminalitetit në shumë vende demokratike, për arsye nga më të ndryshmet, kryesisht ato sociale. Kësaj dukurie nuk i shpëtojnë as vendet e Europës Juglindore, të cilat kanë qenë për shumë vite në tranzicion e me mungesë demokracie të konsoliduar, të tilla si Republika e Maqedonisë së Veriut dhe që do të trajtohet gjerësisht në këtë punim mbi nivelin e saj të kriminalitetit. Humumtiminë tërësinë e tij trajton veprat penale të vjedhjeve në këtë shtet, të cilat si objekt grupor të tyre kanë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar të drejtat që burojnë nga pasuria, si dhe të drejtat që burojnë nga mbrojtja e jetës së individit, të mbrojtura të dyja këto posaçërisht nga legjislacioni penal.

Në këtë aspekt, kjo kategori veprash penale prek në mënyrë të drejtpërdrejtë pasurinë, jetën e individit, si dhe në mënyrë të tërthortë sigurinë publike që ofron shteti ndaj shtetasve të tij nëse cenohen këto marrëdhënie.

Synimi i këtij punimi është të analizojë fenomenin e vjedhjeve në zonën e Maqedonisë së Veriut, duke marrë në tërësi mënyrën e kryerjes së tyre, vendet kryesore të kryerjes, faktorët kryesorë që ndikojnë në të, karakteristikat kryesore të kryerësit të tyre, si dhe mënyrat e parandalimit të tyre. Duke u njohur me të gjithë këto elementë, ne jemi në gjendje të evidentojmë të gjitha problematikat që vijnë nga ky fenomen, si dhe të mund të njihemi me shkaqet, apo faktorët që ndikojnë në të, duke bërë të mundur minimizimin sa më shumë të jetë e mundur e tyre.

Janë analizuar gjithashtu politikat penale, aspekte krimnologjike të kësaj kategorie të veprave penale si dhe disa mënyra e parandalimit të tyre penal. Për të analizuar të gjithë veprat penale më fushën e vjedhjeve, në këtë punim është përzgjedhur të punohet me një qasje metodologjike mikse, të cilët do të analizohen në vijim.

3. Hipotezat.

Punimi “Vjedhjet më të rënda në Republikën e Maqedonisë prej vitit 2013-2019” është realizuar duke u bazuar në hipotezat e mëposhtme:

1. Në legjislacionin penal maqedonas janë harmonizuar parashikimet e instrumentave ndërkombëtarë kundër krimit të organizuar dhe vjedhjeve.
2. Lufta efektive kundër parandalimit të veprave penale të vjedhjes nuk mund të realizohet vetëm nëpërmjet politikës penale dhe masave të saj paramandaluese.

4. Metodologjia e hulumtimit.

Ashtu siç e përmenda më sipër, për përgatitjen e këtij punimi është përdorur një metodologji e plotë, e kombinuar, për mbledhjen e të dhënave dhe informacionit, pra të të dhënave cilësore dhe sasore. Ky raport bazohet në:

- 1) analizën e legjislacionit përkatës maqedonas për ndihmë juridike ndërkombëtare në çështjet penale;
- 2) analizën e raporteve, vlerësimeve, dokumenteve të disponueshme, të dhënave të disponueshme online dhe artikujve të tjerë për ndihmën juridike ndërkombëtare;
- 3) shqyrtimin e marrëveshjeve shumëpalëshe dhe dypalëshe për çështjen në fjalë;
- 4) informacionin zyrtar të marrë në raportet e publikuara nga gjykatat në Maqedoni dhe nga Ministria e Drejtësisë;
- 5) informacionin zyrtar të marrë nga gazetet kryesore maqedonase online;

Metodat e përdorura në këtë punim do të shërbejnë për njohjen e dobësive në funksionimin e sistemit drejtësisë në Republikën e Maqedonisë, si dhe do të ofrojnë rekomandime për përmirësime të mëtejshme.

Duke qenë se normat rregullojnë situata të përgjithshme, **metoda e analizës ligjore** shërben për identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të teorisë dhe të praktikës, nëpërmjet interpretimit të këtyre normave. Gjithashtu, kjo metodë, shërben për të sqaruar paqartësinë e normave, vendosjen e tyre në një rend logjik dhe koherent për të analizuar ndërveprimin e

tyre me normat e tjera. Kjo është dhe metoda e përdorur gjerësisht në këtë punim, ku analiza e dispozitave, është shoqëruar dhe me analizën e praktikës gjyqësore, e cila reflekton mënyrën si këto dispozita zbatohen nga sistemi gjyqësor.

Procesit të interpretimit dhe analizës së legjislacionit, kryesisht në rastet e paqartësisë së normave, i vijnë në ndihmë faktorë të tjerë të jashtëm si **analizimi i aspektit historik, kontekstit social, kriminologjik** etj.

Ky hap konsiston në **rishikimin e literaturës** në lidhje me objektin e studimit dhe përfshin identifikimin, mbledhjen dhe sistemimin e librave, monografive, artikujve shkencorë në fushën juridike, si dhe përzgjedhjen e praktikës gjyqësore për të ilustruar problematikat e ngritura. Zgjedhja e literaturës është shtrirë mbi një numër relativisht të konsiderueshëm autorësh të huaj, si edhe disa autorë vendas.

5. Rëndësia e punimit.

Rëndësia e punimit të kësaj magjistrature, qëndron se faktin se do të studiohet një çështje (fenomen) konkret dhe e nevojshme për opinionin publik, të cilat lidhen me vjedhjet në RMV në nivel komunal. Si qëllimi kryesor i këtij studimi, në mënyre të hulumtimit shkencor është të evidentojë realitetin e kriminalitetit në Maqedoninë e Veriut, luftimin e tij edhe shkallën e rritjes së tij në periudhën kohore 2013-2019.

Qëllimi im gjatë këtij punimi, nga ana ime është të kontribuoj sadopak në të drejtën penale, dhe tek zbatimi i ligjeve të cilat parashikohen për të, edhe pse ka mjaftushmëri njohuri në mënyre teorike dhe praktike për këtë fushë, por gjithësesi mendoj se ende ka nevojë për njohuri në kërkimin e mëjetshëm shkencor të kësaj fushe.

Mendoj se ky studim do të marrë vlerë të mëtejshme, në rast se qytetarët janë të informuar mjaftushem për raste tilla veprash penale, pasi jo të gjithë janë të informuar mbi rëndësinë dhe pasojat që vijnë nga konsumimi i kësaj vepre penale. Për këtë arsye, edhe ky punim është tepër voluminoz në tërësinë e tij, pasi synon të prekë të gjithë aspektet kryesore të realizimit të këtyre veprave penale.

HYRJE

Ballkani është një rajon gjeopolitik i Evropës juglindore², në të cilën jetojnë rreth 55 milion banorë, me identitete të ndryshme dhe nganjëherë edhe të konfrontuara etnike, kulturore dhe politike¹. Gjatë dy shekujve të fundit, Ballkani me të drejtë është trajtuar nga bota perëndimore, si një zonë problematike e Evropës².

Pas përfundimit të konflikteve etnike të shekullit XX, shtetet e Ballkanit, të përkrahura nga Bashkimi Evropian dhe SHBA-të, kanë filluar duke ndjekur politikat aktive të bashkëpunimit me njëri tjetrin si vlera kryesore të standareteve evropiane.

Në realitet edhe përkundër shumë sukseseve të arritura, në disa rajone të brishta të Ballkanit, të tilla si Maqedonia e Veriut, ende paraqitën pengesa në funksionimin e shtetit ligjor dhe zhvillimin e jetës demokratike. Ky shtet, i karakterizuar me një shkallë relativisht të ulët të zhvillimit ekonomik dhe me mungesa të dukshme të konsolidimit të strukturave e institucioneve demokratike, është përballur me fenomene të reja të krimit të organizuar, të

¹Fjala "Ballkan" rrjedh nga turqishtja "Ballkanlar", që do të thotë "një varg i maleve të pyllëzuara".

²Hobsbaëm, Eric. Nationen und Nationalismus. Mythos und Realität seit 1780, Campus Verlag, 1990, Frankfurt am Main.

shfaqura në format e ndryshme të vjedhjeve, që herë herë marrin edhe forma të rënda të shfaqjes së tyre dhe që cenojnë rëndë sigurinë publike të këtij vendi.

Padryshim që ky fenomen kriminal, i organizuar dhe i kryer në forma të ndryshme, përbën një nga forcat kryesore shkatërruese ndaj çdo përpjekjeje për zhvillim shoqëror dhe kultivim të vlerave demokratike në këtë pjesë të Evropës³.

"Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" i shpëtoi shkatërrimit në masë nga lufta dhe shpërnguljes së popullsisë së saj. Si rrjedhojë, situata politike është e stabilizuar, në vend është krijuar një gjendje sigurie dhe institucionet janë në funksionim. Ligjeve ekzistuese u janë bërë ndryshimet e nevojshme, ligjet e reja të miratuara janë në përputhje me standardet dhe rregulloret ndërkombëtare. Proçesi i zbatimit është në rrugë e sipër, gjë e cila sjell një reflektim pozitiv mbi marrëdhëniet ndër-etnike dhe tolerancën midis komuniteteve të ndryshme që jetojnë në vend.

Ka filluar reforma gjyqësore dhe është ndërmarrë me sukses zbatimi i reformës policore të vitit 2005, në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimit. Gjithsesi, vendi është ndikuar nga rënia ekonomike, taksat e larta, papunësia dhe një ekonomi e errët në përmasa të mëdha. Buxheti i shtetit dominon ekonominë e vendit, duke e kthyer shpesh prokurimin publik si të vetmin burim për mbijetesë ekonomike, gjë që shkakton korrupsion. Ashtu dhe si në vende të tjera të rajonit, këta faktorë i siguruan kriminelëve të organizuar mundësi të mëdha dhe avantazhe të pamërituara.

Neni 29 i ligjit për Prokurorinë Publike parashikon një përkufizim ligjor për "krimin e organizuar", i cili është plotësisht i përputhshëm me përkufizimet ndërkombëtar. Gjithashtu në të parashikohen dhe detyrat kryesore të "Njësisë së Luftës kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit" brenda Zyrës së Prokurorisë Publike të vendit në njërin anë dhe detyrat e sektorit të sapoformuar për Luftën kundër Krimin të Organizuar, brenda Ministrisë së Brendshme, në anën tjetër.

"Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" mendohet të jetë e kërcënuar nga krimi i organizuar, kryesisht trafiku i drogës, transporti klandestin i personave, kontrabanda e armëve

³Krasniqi, K., Kriminalistik 10/2009, f.566-569.

dhe e një sërë mallrave (cigareve, alkoolit, karburantit, etj) dhe aktiviteteve të krimit ekonomik, si vjedhjet, mashtrimet në prokurimet publike, falimentimet, mashtrimet në privatizime, etj.

KAPITULLI PARË

KARAKTERISTIKAT LIGJORO PENALE TË VEPRAVE PENALE – GRABITJET DHE VJEDHJET E RËNDA

1. Veprat penale kundër pronës.

Vjedhja e pasurisë përbën një ndër veprat penale më të rëndësishme dhe më të rrezikshme në legjislacionin penal, pasi nëpërmjet tyre preket një objekt i rëndësishëm siç është ai i pasurisë, apo sigurisë së jetës e shëndetit të individit. Për këtë arsye, ajo parashikohet si kategori më vete e veprave penale në dispozitat e legjislacionit penal të një vendi. Nëse do të jemi përpara veprës penale të vjedhjes së pasurisë, atëherë do gjendemi përballë pasurive të përdorura për të kryer krime, që në këtë rast shërbejnë si mjete, si dhe të ardhurat e përfituara nga konsumimi i vjedhjes.

Të ardhurat shpesh përcaktohen si fitime, ose përfitime materiale të realizuara nga krimi. Të ardhurat mund të ndahen në të ardhura të drejtpërdrejta nga krimi, të quajtura ndryshe edhe objekti dhe të ardhurat e tërthorta nga krimi. Nëse i referohemi shembullit të një vjedhje me

armë të bankës, instrumentet⁴ do të ishin arma e përdorur për të kërcënuar stafin e bankës dhe makina për arratisje, ndërsa të ardhurat e drejtpërdrejta do të ishin paratë e marra nga banka dhe të ardhurat e tërthorta do të ishin pasuria e re e blerë, apo e përfituar për tëblerë duke përdorur paratë cash.

Konventa e Varshavës jep në mënyrë të detajuar konceptin e pasurisë dhe nëse i referohemi asaj, me termin "pasuri" nënkuptohet: *“çdo lloj aseti, si fizik edhe jofizik, i luajtshëm ose i paluajtshëm, i prekshëm ose i paprekshëm, dhe dokumentet ose instrumentet ligjore që vërtetojnë pronësinë ose interesat në këto asete”*⁵. Ndërsa pasuria e përfituar nga vjedhja, ose termi "produkte të krimit" nënkupton *“çdo pasuri që rrjedh ose përfitohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nëpërmjet kryerjes së një shkelje”*.

Me termin "të ardhura" nënkuptohet: *“çdo avantazh ekonomik, që rrjedh ose përfitohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga veprat penale”*⁶.

Vjedhja konsiderohet si vepra penale më e vjetër në të drejtën penale, e cila është njohur që në të drejtën romake me termin *“fortum”*. Vjedhja, apo fortumi në të drejtën romake ishte krim, që do të thoshte cënim i pasurisë së huaj, krahas nxjerrjes së njëkohshme të dobisë për delikuentin⁷. Ky ishte kuptimi fillestar i vjedhjes, përmbajtja e të cilit më vonë do të zgjerohet me qëllim të ruajtjes sa më të sigurtë të poseduesve të pronës nga shtresat e varfëra. Vjedhja është përvetësimi i qëllimshëm kundërligjor i pronës së luajtshme, e kryer me qëllim të përfitimit.

Veprat penale kundër pasurisë bëjnë pjesë në të ashtuquajturin kriminalitet klasik dhe janë të njohura edhe me ligjet penale më të vjetra. Me pasuri, nënkuptohen sendet e luajtshme dhe të paluajtshme, të drejtat pronësore dhe interesat pronësore⁸, të cilat i takojnë personit fizik dhe juridik. Mbrojtja juridike penale e pronës private, daton që nga koha e lindjes së shtetit dhe së drejtës. Në kuptimin e gjerë, në veprat penale kundër pasurisë bëjnë pjesë të gjitha ato vepra,

⁴ Sipas Konventës së Varshavës së KE-së, koncepti "Instrument" nënkupton çdo pasuri të përdorur, ose që synon të përdoret, në çfarëdo mënyre tërësisht ose pjesërisht, për të kryer një ose disa vepra penale.

⁵ UNCAC A. 2(d); Konventa e Varshavës e KE-së A. 1(b))

⁶ Asetet mund të përbëhen nga çdo pasuri, siç përcaktohet në këtë nen. (Konventa e Varshavës e KE-së A. 1(b))

⁷ Salihu, Ismet, E drejta penale, pjesa e veçantë, Prishtinë, 2009, fq. 339.

⁸ Halili, R., Kriminologjia, Prishtinë, 2011

të cilat janë të drejtuara kundër pronës, gjegjësisht që kryerësi vetes t'i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme, pa marrë parasysh se a gjenden në këtë grup, apo në ndonjë grup tjetër të veprave penale. Në raport me veprat penale, të cilat janë kryer në të kaluarën, veprat e sotme penale, kryesisht dallohen sipas mënyrës, formës dhe teknikës së kryerjes.

Edhe sot ekzistojnë vepra penale kundër pasurisë si: vjedhje, vjedhje të rënda, vjedhje grabitqare, mashtrime dhe vepra penale të tjera klasike, por mënyra e kryerjes së veprave penale ka ndryshuar, duke i'u përshtatur raporteve të reja pasurore, si dhe mundësive bashkëkohore, teknike dhe mjeteve të cilat shfrytëzohen gjatë operacioneve dhe transaksioneve të ndryshme financiare.

Në ditët e sotme vjedhjet, mashtrimet dhe veprat të tjera kryhen në mënyra tepër të sofistikuar përmes futjes, fshirjes apo ndryshimit të të dhënave kompjuterike, apo programeve dhe mënyrave tjera të ndikimit në rezultatet e procedimit të përpunimit elektronik të të dhënave përmes të të cilave kryhen dobi pasurore të kundër ligjshme jashtëzakonisht të mëdha. Mbrojtja e pasurisë, e cila përfshin jo vetëm sendet-objektet, por edhe mbrojtjen e të drejtave pasurore dhe interesave pasurore në masën më të madhe realizohet me masat e së drejtës civile dhe ekonomike, ndërsa me aplikimin e sanksioneve penale, vetëm kur vjen deri te cenimi, apo rrezikimi i pasurisë, ka ardhur përmes përdorimit të forcës, k ërcënimit⁹, shantazhit apo përmes veprimeve të ngjashme, që janë me rrezikshmëri shoqërore.

Mund të theksohet, se kjo mbrojtje është e kufizuar për arsye se, kryesisht ka të bëjë me cenimin e drejtave pasurore, që janë gjëra të luajtshme, ndërsa në raste të rralla te ato të paluajtshme dhe për arsye se me këtë mbrojtje janë përfshirë cenimet të bëra me paramendim. Megjithatë, pa marrë parasysh nivelin e kufizuar të mbrojtjes juridike penale pasurisë, rëndësia e kësaj mbrojtje është e pakontestueshme. Në kuadër të mbrojtjes juridike të pasurisë, mbrojtja juridike penale pa dyshim paraqet vetëm një pjesë të saj, por specifike dhe shumë të rëndësishme, se pa mbrojtjen juridike penale nuk mund të mendohet mbrojtja

⁹ Salihu, I., E drejta penale, pjesa e veçantë, Prishtinë, 2009, fq. 339

efikase dhe efektive e pasurisë. Për këtë dëshmojnë, veçanërisht numri jashtëzakonisht i madh i veprave penale të vjedhjes në botë¹⁰.

Nëse marrim shembullin e vendeve të Ballkanit, ekzistojnë raporte zyrtare¹¹, të cilat theksojnë nivelin e rritjes së kriminalitetit në këto vende përbërëse të këtij rajoni, në të cilat ndër veprat kryesore të kryera prej organizatave kriminale, mund të përmendim edhe vjedhjet e shumta që realizohen prej tyre me qëllim përfitimi. Në këtë kuadër, Observatori i Shoqërisë Civile Kundër Krimin të Organizuarështë shprehur se: "*Ballkani ka ende punë për të bërë. Sidomos kur vjen fjala tek lufta kundër krimin të organizuar në rajon, i cili ndryshe nga politika bën bashkë të gjithë grupet kriminale, pa dallim kombësie*".

Ky raport ka si qëllim forcimin e rolit të shoqërisë civile në luftën kundër krimin të organizuar, korrupsionit dhe vjedhjeve. Ai përmban të dhëna të detajuara mbi qytetet apo zonat kryesore, pikat kufitare, ose nyjet kyçe që janë më të predispozuar për t'u përdorur nga trafikantët e drogës, armëve, qenieve njerëzore, kryerësit e vjedhjeve dhe të tjera veprimtarive kriminale që kryhen në Ballkan.

Hulumtimet e EUROSTAT-it na japin një tablo të përgjithshme dhe detajuese lidhur me kryerjen e veprës penale të vjedhjes në Maqedoni, ku ndër to specifikohet:

- "*Në vitin 2016 në Maqedoni ka pasur 24.755 vepra penale, ndërsa si vit i "lulëzimit" të krimin mund të quhet viti 2013 me 30.365 vepra penale;*
- *Në 6 vitet e fundit ka pasur 26.494 vepra të krimin klasik i vjedhjes (krim i cili realizohet me përdorimin e thikës apo pistoletës), ndërsa në vitin 2016 kemi 22.732 veprapenale;*

¹⁰ Fletcher, George P. (1998). Konceptet themelore të së drejtës penale . Oxford University Press. ISBN 0-19-512170-8.

¹¹ Observatori i Shoqërisë Civile Kundër Krimin të Organizuar në Evropën Juglindore, si pjesë e Iniciativës Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar, publikoi në datë 20.05.2020 në Vjenë raportin me të dhënat e mbledhura nga 20 ekspertë dhe gazetarë vendas nga shoqëria civile në Shqipëri, Bosnjë Hercegovinë, Kosovë, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, dhe në Serbi. Me temën "Zonat problematike të krimin të organizuar në vendet e Ballkanit Perëndimor".

- *Si vit që më shumti ka pasur vepra penale të këtij lloji është viti 2013 në të cilën ka pasur 28.628 vepra penale;*
- *Krimi i organizuar vjen me rënie të vogël në vitet 2010-2016, ku nga 309, tani është 259 vepra penale. Shohim se kemi një rritje të krimit të organizuar gjatë vitit 2015, ku numërohen 342 vepra;*
- *1365 vepra penale të krimit ekonomik janë regjistruar në vitin 2010, ndërkaq në vitit 2016, 1.166, mes këtyre viteve numri më i madh i krimeve të këtij lloji ka ndodhur në vitin 2011, gjegjësisht janë regjistruar 1376 vepra penale;*
- *Lidhur me vjedhjet e automjeteve, nga viti 2018 deri në 2019, janëpërgjysmuar vjedhjet e automobilave në Maqedoninë e Veriut. Statistikat e policisë së shtetit në këtë vend tregojnë se gjatë vitit 2018, janë regjistruar gati 500 vjedhje të automobilave. Ndërkohë, të dhënat e këtij viti flasin se në territorin e RMV-së, nga janari e deri në shtator janë vjedhur 261 automobila¹²;*
- *Sipas të dhënave zyrtare të marra nga Ministria e Punëve të Brendshme, në nëntë vitet e fundit, vjedhja e automobilave ka rënë me 29%”.*

Vjedhja e automjeteve përbën një problem vërtet shqetësues për banorët e Maqedonisë së Veriut, pasi kjo vepër konsumohet mësëshumti. Në shënjestër të autorëve të vjedhjes së veturave zakonisht kanë qenë¹³, por edhe vazhdojnë të jenë automjetet që kushtojnë shtrenjtë, pasi ato rishiten ose shiten për pjesë këmbimi. Në këto raste autorët veprojnë gjatë kohës kur pronarët e veturave, janë treguar neglizhent dhe i kanë lënë çelësat brenda në vetura, dhe janë larguar me nxitim për të paguar ndonjë faturë, apo për të kryer ndonjë shërbim tjetër në bankë. Lokacione tjera atraktive për vjedhjen e automobilave janë parkingjet publike, respektivisht viktima të këtyre ndodhive shpesh herë janë edhe shtetas të huaj.

¹² Të dhënat janë publikuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

¹³ Viteve të kaluara disa prej vjedhjeve të automobilave kanë ndodhur në bulevardin “Aradhet Partizane”, në Shkup.

Autoritetet policore kanë realizuar një varg aksionesh për arrestimin e autorëve të specializuar për vjedhjen e veturave. Disa prej këtyre aksioneve në vitet 2013 dhe 2017 u realizuan në fshatin Gërçec, rrethinë e Shkupit, ku mbetën të arrestuar katër persona, të akuzuar se kanë vjedhur vetura dhe më pas për kthimin e automobilave, në mënyra të ndryshme i kanë shantazhuar pronarët e veturave. Në disa prej rasteve ka pasur edhe kërcënime me jetë që ngjarjet mos të denoncohet në polici.

2. Karakteristikat ligjore penale të veprave penale – grabitje dhe vjedhjet e rënda.

2.1. Rëndësia ligjore e veprës.

Veprat me të cilat cenohet apo dëmtohen vlerat juridike të njeriut, apo marrëdhëniet juridike të cilat mbrojnë këto vlera, në legjislacionin penal do të quhen vepra penale. Pra, vepra penale e vjedhjes zë vend qendror në të gjitha legjislacionet penale¹⁴ bashkëkohore, edhe pse përkufizimet për të janë të shumta. Me vepër penale të vjedhjes kuptojmë kur ajo kryhet kur dikush merr *“pasuri të një personi tjetër me qëllimin që në mënyrë të paligjshme ta përvetësojë atë për veten e tij”*. Vepra penale e vjedhjes kryhet kur jemi përballë këtyre elementëve:

- një person përvetëson fitim pasuror nga një tjetër në mënyrë të kundërligjshme;
- kur ky veprim parashikohet në legjislacion si vepër penale;
- kur është përcaktuar sanksioni penal për të ose masa e trajtimit të detyrueshëm.

Vjedhja përfshin një term të përgjithshëm që mbulon një shumëllojshmëri të llojeve të veçanta të vjedhjes, duke përfshirë krimet e vjedhjes si grabitja, mashtrimi, placktija, etj. Kjo vepër penale është e përhapur në gjithë botën dhe realizohet në forma të ndryshme.

¹⁴ Ligji ndërkombëtar penal.

Objekt i vjedhjes mund të jetë vetëm pasuria, e luajshme dhe e paluajshme. Nëse sendi nuk është në pronësi të askujt, apo nëse është i braktisur, atëherë nuk bëhet fjale për vjedhje, por për pushtim, e cila njihet si formë e fitimit të pronësisë¹⁵.

Lidhur me **anën subjektive**, kjo veprë penale mund të kryhet vetëm me dashje. Nëse autori i veprës i'a kthen pasurinë personit të demtuar para se të filloj procedura ligjore ndaj tij, ligji parashikon që ai edhe mundet të lirohet.¹⁶

Në mënyrë që të mund të jemi përballë veprës penale të vjedhjes, duhet të plotësohen tre kushte:

- (1) mallrat duhet të hiqen nga posedimi i një tjetri pa pëlqimin e pronarit;
- (2) mallrat jo vetëm që duhet të merren, por edhe të "largohen", një kërkesë që është shumë formaliste dhe është e kënaqur me çdo lëvizje të të gjithë objektit, sado e lehtë; dhe;
- (3) duhet të ketë një qëllim për të vjedhur, i cili zakonisht përkufizohet si një qëllim për të privuar pronarin përgjithmonë nga prona e tij.¹⁷

Huazimi i paautorizuar i pronës së tjetrit nuk është vjedhje nëse ka një qëllim për kthimin e pronës, as vjedhje e kryer nga dikush që merr mallra në besim të gabuar se ato i përkasin atij.

Nga **ana objektive**, kjo veprë kryhet në rrethana të përdorimit të dhunës dhe përfshin zbatimin apo kërcënimin e forcës për të kryer vjedhjen ose për të siguruar arratisjen. Grabitja mund të ndodhë në forma të ndryshme. Në këto raste dënimi për grabitje zakonisht është më i rëndë se ai për vjedhje të tjera për shkak se kemi më shumë persona që bashkëpunojnë për realizimin e saj¹⁸, duke paraqitur në këtë mënyrë një shkallë rrezikshmërie më të lartë për rendin juridik.

Vjedhjet mund të realizohen në forma të ndryshme si, thyerja dhe hyrja tek objektet e njëjtëri me qëllim për të kryer një krim brenda me qëllim përfitimi. Edhe pse motivimi i autorëve

¹⁵Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, "Mënyrat e fitimit të pronësisë"

¹⁶ Van den Haag, Ernest (1978). Ndëshkimi i kriminelëve: në lidhje me një pyetje shumë të vjetër dhe të dhimbshme.

¹⁷ Fletcher, George P. (1998). Konceptet themelore të së drejtës penale . Oxford University Press.

¹⁸Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, 2017.

është vjedhja, qëllimi për të kryer vepra të ndryshme të tjera, të shoqëruara me të, konverton një shkelje në një vjedhje. Për shembull, është e mundur të kryhet vjedhje me qëllim të përdhunimit. Sistemet ligjore të bazuara në ligjin e zakonshëm tradicionalisht dallohen midis vjedhjes dhe mashtrim, një dallim i ruajtur ende në shumë juridiksione.

Sidoqoftë, të dy krimet konsiderohen si të përjashtuara reciprokisht dhe përgjithësisht pranohet se një krim mund të përfshijë vjedhje dhe mashtrime (p.sh. vjedhjet dhe shitjet e mëvonshme të një automjeti). Vjedhja gjithashtu dallohet zakonisht me përvetësim, në të cilin autori transporton mallra, posedimi i të cilave i është besuar ligjërisht. Ashtu si me mashtrimet, vjedhja është një krim i veçantë nga përvetësimi, por dy veprat nuk janë ekskluzive reciprokisht.

Karakteristikë themelore e numrit më të madh të veprave kundër pasurisë, është përvetësimi i kundërligjshëm i objektit pasuror. Këtu përfshihen: psh. vjedhjet, vjedhjet e rënda, vjedhjet grabitqare, shantazhi¹⁹, etj.

Ekzistojnë vepra penale, të cilat nuk ekziston asnjëri prej këtyre qëllimeve që sapo përmendëm, pasi qëllimi i marrjes së sendit të huaj për shkak të shërbimit dhe përdorimit për qëllimet për të cilat është destinuar, në mënyrë që pas kësaj përsëri t'i kthehet pronarit të mëparshëm. Vepra të tilla janë të njohura edhe nga e drejta penale romake si shfrytëzim i kundërligjshëm i sendit pa qëllim të përvetësimit.

Anën subjektive të të gjitha veprave penale kundër pasurisë e përshkon paramendimi, sepse përveç qëllimit si karakteristikë subjektive, këto vepra mund të dallohen edhe sipas disa rrethanave objektive²⁰. Ato kryhen nga motivet e ndryshme që kanë autorët e tyre, si nga kushtet ekonomike dhe sociale, arsimimi i ulët, qëllimi për përfitim të shpejtë, si dhe nga ana psikike e tyre.

¹⁹ Këto vepra penale kryhen vetëm me qëllim që ta mbajë në posedim të vetin, por pa pasur qëllim të përvetësimit.

²⁰ H. Abadinsky., "Organized Crime "(Seventh edition), 2003.

Veprat penale të vjedhjes në Maqedoni përfshihen në Kodin Penal, në Kreun XXIII, si Vepra Penale kundër Pasurisë, ndërsa “Vjedhja” përcaktohet në nenin 235 të këtij Kodi, e cila parashikon se:²¹

Në nenin 235 vjedhja parashikohet:²²

“Ai i cili nga tjetëri do të merr send të luajtshme me qëllim që në mënyre të kundërligjshme ta përvetësojë atë, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet”.

Ndërsa në Paragrafin.2 thuhet: *“Nëse vlera e sendit të vjedhur është më e vogël dhe kryerësi ka shkuar kah që ta përvetësojë sendin me asi vlere, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vjet”.*

Paragrafi.3 përcakton: *“Me dënimin nga parg.1 të këtij neni, do të dënohet edhe kryerësi që do të merr dru nga pylli i huaj sasia e të cilëve është më e madhe se një metër kub me qëllim për përvetësim të kundërligjshëm.”*

Parg.4 thotë: *“tentim për veprat nga parg.1,2 dhe 3 është i ndëshkueshëm”*

Parg.5 parashikon: *“ndjekja për veprën nga parg.2 të këtij neni ndërmerret padi private”*

Në Republikën e Maqedonisë, sipas Kodit Penal parashikohen këto vjedhje:

- Vjedhja e rëndë,
- Grabitja,
- Vjedhja grabitqare,
- Fshehja,
- Të shërbyerit,
- Marrja e sendeve të huaja,
- Marrja e automjetit,
- Dëmtimi i sendeve të huaja,
- Dëmtimi i të drejtave të huaja,
- Ndërtimi i paligjshëm,

²¹ Vllado Kambovski&Ismail Zejneli, Drejta Penale - Pjesa e përgjithshme –Tetove, 2018.

²²E drejta penale në Maqedoni, Afrim Osmani, 2014.

- Mashtrimi,
- Mashtrimi i blerësve,
- Dëmtimi dhe hyrja e paautorizuara në sistemin kompjuterik,
- Mashtrimi kompjuterik,
- Keqpërdorimi i besimit;
- Falementimi i rrejshëm,
- Shantazhi,
- Fajdexhilleku,
- Pendimi i veprës së krijuar, etj.

Këto vepra mund të kryhen me thyrje, ose me dhunë në hapsirat e mbyllura, me pengesa të medha, bashkëpunimi i shume personave të bashkuar për shkak të kryrjes sëvjedhjes, vjedhje e sendeve me vlerë me përmasa të mëdha, në këto vepra përdoret forca dhe kërcënimi i drejtpërdrejtë qësulmo jetëne dikujt, përvetësim i kundërligjshëm i sendit, shkaktimi i lëndimeve të rënda trupore, përdorim i armëve të zjarrit, etj.

Dënimet që aplikohen për këto vjedhje janë me burgim, e cila zgjat prej 3,5 deri 10 vjet dhe gjithashtu me gjobë, e cila varet prej rëndësisë së veprës penale dhe siç e parasheh ligji.

2.2. Subjekti aktiv – kryersi i veprës.

Subjekt aktiv i kësaj veprës penale mund të jetë çdo person fizik dhe juridik, i cili ndërmerr kryerjen e këtyre veprimeve. Legjislacioni penal ngarkon me përgjegjësi penale çdo person i cili ka mbushur moshën për të marrë përsipër përgjegjësi. Edhe të miturit nga mosha 14-18 vjeç mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre penale, në përputhje me pasojat e ardhura nga vepra penale dhe marrin dënimin për të.

Në realizimin e veprës penale të vjedhjes, subjekt aktiv mund të jetë një subjekt i përgjithshëm, pra me cilësi të përgjithshme, mashkull apo femër, nga mosha 14 vjeç e deri në moshë të pakufizuar.

Gjithashtu vjedhjet realizohen edhe nga subjekte juridik, të cilët nëpërmjet organeve të tyre vepruese, ose personave me cilësi të posaçme ndërmarrin veprime aktive që tërealizojnë këto llojveprime mashtrimi, apo vjedhje.

2.3. Subjekti pasiv – viktima.

Si subjekt pasiv, ose viktimë në këto lloj vjedhjesh mund të jetë kushdo person i cili posedon pasuri të tijën të paluajtshme²³, ose më përdorim të tij, duke e zhveshur në këtë mënyrë nga posedimi i saj. Duke realizuar vjedhjen e tij, subjektit pasiv i shkaktohet pakësim i pasurisë së tij, si dhe gjithashtu dëm moral apo psikologjik në raste kur vjedhja shoqërohet me përdorim arme.

Në shumë raste subjektit pasiv i cenohet edhe jeta e tij, pasi nuk janë të pakta rastet kur ata kanë mbetur të vrarë, apo të plagosur gjatë realizimit të vjedhjes.

2.4. Objekt i mbrojtjes.

Me objekt të mbrojtjes, në të drejtën penale nënkuptojmë të mirat juridike që janë të mbrojtura nga rendi juridik e shoqëror, dhe veprat penale që janë të drejtuara kundër këtyre të mirave apo vlerave, të cilat janë të mbrojtura nga sistemi juridik i një vendi, si dhe në të drejtën ndërkombëtare. Pra, objekt i veprës penale është e mira juridike kundër të cilës është e drejtuar vepra penale.

Në të drejtën penale, si objekt i veprës penale konsiderohen të mirat, ose vlerat e njeriut, të një populli, të një vendi dhe komuniteti ndërkombëtar dhe këtu hyjnë: (jeta e njeriut, intergriteti i tij fizik e moral, liritë dhe drejtat themelore të njeriut, qytetarit, siguria, paqja, barazia, etj)²⁴.

²³ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, vjedhjet.

²⁴Salihu, I., “E drejta penale e përgjithshme”, botimi i katërt, 2010, Prishtinë.

Objekti i veprës penale ka qenë e pranishme në gjitha fazat e drejtës penale, që nga koha e shoqërive fillestare, deri te shoqëritë mëdemokratike. Në të drejtën penale njihen dy lloje të objektit të veprës penale, objekti i përgjithshëm dhe grupor. Si objekt i përgjithshëm është tërësia e të gjitha të mirave juridike që janë të mbrojtura në të drejtën penale dhe që paraqesin objekt të përgjithshëm të veprave penale. Ndërsa objekti grupor është konkretizimi i objektit të përgjithshëm të veprës penale, i cili përfshin disa objekte të posaçëm të mbrojtur nga legjislacioni penal.

Gjithashtu për t'u bërë objekt duhet të kemi veprim, që do të thotë që personi apo vlera tjetër juridike, ndaj të cilit është ndërmarr kryerja e veprimit dhe dëmtohet apo rrezikohet objekti që mbrohet nga drejta penale. Objekt i vjedhjes janë sendet e luajtshme. Me veprim të kryerjes së veprës penale është e përcaktuar, marrja e pasurisë së huaj të luajtshme, në çfarëdo mënyre përvetësimi²⁵.

Gjithashtu si objekt nuk mund të jenë sendet e braktisuara, apo sendet për të cilat nuk dihet se të kujt janë, por ato mund të jenë edhe dokumentet me cilat realizohet ndonjë e drejtë psh: E vjedhjes së karteles së bankës. Duhet të theksojmë se objekti i vjedhjes duhet të jenë sendet e luajtshme, që nënkuptohet se me pasuri të luajtshme përfshihen të gjitha sendet të cilat mund të lëvizin nga një vend, në tjetrin, pa e dëmtuar thelbin e tyre. Sipas mënyrës së kryerjes, dallohen veprat e rrëmbimit (vjedhja, vjedhja e rëndë, grabitja, etj), veprat e përvetësimit (psh. shpërdorimi), veprat të cilat kryhen me përdorimin e forcës dhe kërcënimit (detyrimi, shantazhi), veprat të cilat kryhen me mashtrim apo shfrytëzim, gjegjësisht me keqpërdorimin e ndonjë rrethane (psh. mashtrimi, kontraktimi joproporcional)²⁶.

Veprimi shprehet tek veprat penale që kryhen me veprim dhe mos veprimi, të cilat vlejné edhe për veprat penale të vjedhjes, si vepra të kryra me dashje, pakujdesia, tentativë ose dhe forma të ndryshme të kryerjes së veprës penale të vjedhjes²⁷. Si veprim në drejtën penale kuptojmë të gjitha sjelljet, apo veprimet e njeriut që manifestohen në botën e jashtme dhe me të cilat janë të përcaktuara në ligj që janë të ndaluara si vepra penale.

²⁵ Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prof, Ismet Salihu, Prof, Hilmi Zhitija, Prof. Hasan Fejzullahu, botimi 2014, Prishtinë.

²⁶ E drejta penale, Prof. Borisllav Petroviq, botimi 2006, fq. 33, Sarajevë, Prishtinë.

²⁷ E drejta penale e përgjithshme, Prof. Ismet Salihu, ribotimi 2010, Prishtinë.

Tek veprat penale të vjedhjes, mund të themi se ato kryhen me vullnetin e brendshëm të njeriut, siç janë mendimi. Dëshira, mendimi dhe qëllimi i kryerjes së veprës penale, nuk mundën të konsiderohen veprime në kuptim juridik-penal dhe nuk ndëshkohen nëse ato nuk manifestohen në botën e jashtme. Pra, personi që kryen një vjedhje, duhet patjetër ta shoqërojë atë me një veprim të vullnetshëm. Gjithashtu dhe veprimi me mosveprim si mënyrë e kryerjes së veprës penale, duhet të jetë i vullnetshëm. Veprat penale mund të kryhen dhe me qëndrimin pasiv të njeriut në rrethana të caktuara, për shkak të qëndrimit, i cili shkaktohen pasoja të ndaluara në botën e jashtme.

Zakonisht menjëherë pas ndërmarrjes së veprimit shkaktohet pasoja e veprës penale. Në këto raste, nuk paraqitet asnjë problematikë lidhur me përcaktimin e kohës së kryerjes së veprës penale, ngaqë përputhet koha e ndërmarrjes së veprimit dhe koha e shkakimit të faktorit.²⁸ Mirëpo, në praktikë ndodh që veprimi të ndërmerret në një kohë, kurse pasoja të shkaktohet në kohën tjetër, më vonë, psh. Tek vepra penale e mashtrimit, nënkuptojmë që kryersi i veprës penale, i sjell vetes apo personit tjetër dobi pasurore, të kundërligjshëm që ndodh si nëmashtrime ekonomike që shkaktohen pasoja me vonë, ose në përdorimin e dokumentave të rrema, etj.

Çështja e përcaktimit të kohës së kryerjes së veprës penale ka rëndësi të posaçme praktike. Kjo rëndësi konsiston në faktin së prej kohës kur konsiderohet së është kryer vepra penale varet se cili ligj do të aplikohet, ligji që ka qenë në fuqi në kohën kur është ndërmarrë veprimi, apo ligji që ka qenë në fuqi në kohën kur është shkaktuar pasoja. Mandej sipas kohës së kryerjes së veprës penale përcaktohet përgjegjësia penale e autorit të dhe përcaktimi i sanksioneve penale, në varësi kjo nëse autori ka qenë person i mitur, i rritur, madhor, i përgjegjshëm, etj. Afati i parashkrimit fillon të ecë prej momentit të kryerjes së veprës penale dhe në fund, në disa raste koha e kryerjes së veprës penale është element konstituiv i figurës së veprës penale. Kështu, sipas kodit penal vepra penale konsiderohet së është kryer në kohën kur personi ka vepruar, apo ka qenë i detyruar të veprojë pa marrë parasysh kohën kur është shkaktuar pasoja.²⁹

²⁸ E drejta penale- pjesa e përgjithshme, Prof. Dr. Vllado Kambovski, Shkup, 2006.

²⁹ Gazeta Zyrtare, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, nr.19/Korrik 20012, Prishtinë;

2.4. Ana subjektive e veprës.

Motivi është një element përcaktues i anës subjektive të veprës penale. Ai është element psikologjik i jetës shpirtërore, e cila e shtyn personin të ndërmarrë veprimin e caktuar. Motivi është element i ndryshëm nga qëllimi, por që motivi është ai element që të shtyn drejt realizimit të veprës penale. Vepra penale konsiderohet se është kryer me dashje, pa marrë parasysh se a është kryer me motiv të caktuar. Kur motivi nuk është parashikuar si element konstituiv i veprës penale, ai merret si rrethanë rënduese apo lehtësuese me rastin e matjes së dënimit. Mirëpo në legjislacionin penal, disa vepra penale konsiderohet se ekzistojnë vetëm nëse janë kryer me motive të caktuara, p.sh. vepra penale vjedhja e rëndë, zjarrvënja, shantazhi, etj.

Nëse këto vepra nuk janë kryer nga motivet e caktuara, atëherë është fjala për vepra të tjera penale. Nga kjo mund të arrijmë në përfundimin se në disa raste të parashikuara shprehimisht me ligj, motivi shfaqet si element thelbësor i veprës penale, e nëse motivi nuk është i parashikuar si element kualifikues i veprës penale, ai mund të merret qoftë si rrethanë lehtësuese, apo rënduese me rastin e matjes së dënimit. Veprat penale të këtij kapitulli mund të sistemohen sipas motivit të kryerjes së tyre:

1. Veprat penale të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme;
2. Veprat penale të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme;
3. Veprat penale të cenimit të të drejtave të huaja;
4. Marrja dhe shkatërrimi i sendit të huaj;
5. Veprat penale të keqpërdorimit;
6. Veprat penale të mashtrimit, shantazhit dhe detyrimit.

2.5. Bashkëpjesëmarrje dhe bashkëkryerje.

Bashkëpunimi në mes grupeve rajonale të krimit të organizuar, dëshmohet edhe përmes shumë rasteve të hetuara, kur para të gjitha gjykatave të shteteve të Ballkanit, paraqiten përsona të dyshuar me shtetësi ose përkatësi të ndryshme etnike si shqiptarë, serbë, boshnjakë, malazezë, turq, hungarezë, austriakë, ukrainas etj³⁰.

Bashkëpunimi në mes grupeve rajonale të krimit të organizuar në Ballkan dëshmohet edhe përmes raporteve të organizatave ndërkombëtare për luftimin e kriminalitetit. Kështu sipas Evropolit, trafikimi i heroinës në Bashkimin Evropian nuk organizohet ose kontrollohet vetëm nga një organizatë kriminale, por zhvillohet përmes një bashkëpunimi dhe partneriteti të vendosur në mes organizatave turke dhe disa grupeve kriminale kryesisht nga Ballkani Perëndimor³¹.

Dukuria e bashkëpunimit në mes grupeve kriminale me përkatësi të ndryshme etnike ose fetare në Ballkan dëshmon faktin se krimi i organizuar nuk njihet ligje, kufinj shtetërorë, kombe ose fe, por njihet vetëm interesin e tyre material³². Për këtë arsye, me të drejtë arrihet në përfundimin se: “Ballkani është një rajon ku personat me përkatësi të ndryshme etnike ose religjioze luftojnë kundër njëri tjetrit dhe në të njëjtën kohë bashkëpunojnë me njëri tjetrin në sferën e krimit³³.

Nuk janë të rralla rastet kur në kryerjen e një veprë penale marrin pjesë më shumë persona. Praktika tregon se në raste të tilla ekzistojnë shumë forma të ndryshme të veprimtimit të përbashkët dhe shkallë të ndryshme të kontributit të pjesëmarrësve në kryerjen e veprës penale. Ekzistojnë bashkimet kriminale të organizuara mirë dhe me strukturë udhëheqëse që merren me kriminalitet si një lloj i veprimtarisë së përhershme, por ekzistojnë edhe forma tjera të veprimtarisë së përbashkët kriminale me shkallë më të ulët të organizimit, ose më saktë bashkëpunim për vepra më të lehta penale, të tilla si vjedhje të thjeshta.

³⁰Riegler, Henriette, *Contextualizing Criminality and Security in South Eastern Europe*, in: Connections (Volume II, Number 2), Partnership for Peace Consortium of Defense Academies and Security Studies Institutes, faqe 51-53, 2003.

³¹<http://ëëë.mapo.al/2013/02/01/raporti-grupet-shqiptare-rol-kyc-ne-trafikun-e-heroines-bashke-me-turqit/>

³²Manuela Riedeland, Marnix Eichelberg: Bashkëpunimi rajonal në Evropën Juglindore – Periudha pas Paktit të Stabilitetit, Programi për politikë të jashtme dhe siguri, 2009 Shkup.

³³Richard Kauzlarich, ish ambasadori amerikan në Bosnje në vitin 1990, Black Sea and Caspian Sea Symposium 9-10 March 2006, National Defense Intelligence College Washington, DC, f. 56

Për të ekzistuar bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale nuk mjafton vetëm pjesëmarrja e dy apo më shumë personave, por duhet të ekzistojë lidhja objektive dhe subjektive midis bashkëpunuesve. Kjo për arsye se është e mundur situata kur dy ose më shumë persona kryejnë veprën penale të vjedhjes, mirëpo veprimtaria e tyre ka qenë e pavarur. Kështu, p.sh. një e thyen xhamin e një shitore dhe, me qëllim të përvetësimit i merr disa artikuj, e në ndërkohë atypari kalon edhe personi tjetër, i cili po ashtu me qëllim të përvetësimit, i merr disa artikuj.

Lidhja objektive të bashkëpunimi qëndron në atë se secili bashkëpunues duhet të ndërmarr ndonjë veprim me të cilin kontribuon në kryerjen e veprës penale, me qëllim që të shkaktohet pasoja e caktuar si rezultat i përbashkët i veprimeve të bashkëpunuesve. Lidhja subjektive qëndron në atë se të gjithë bashkëpunuesit duhet të jenë të vetëdijshëm se veprojnë në mënyra të ndryshme me qëllim të përbashkët, me ç'rast nuk është e domosdoshme që ata të njihen mes veti. Sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë bashkëpunim quhet kryerja e veprës penale nga dy ose më shumë persona me marrëveshje ndërmjet tyre³⁴.

2.6. Nxitje (inkurajim) dhe dhënie ndihme në kryerjen e veprës.

Shtytja është njëra nga format e bashkëpunimit në kuptimin e ngushtë. Në teori dhe në praktikë shtytja përkufizohet ndërmarrje e veprimeve të atilla me të cilat të personi tjetër me dashje shkaktohet ose forcohet vendimi për të kryer veprën penale. Sipas KPRSH³⁵ shtytës konsiderohet personi që nxit bashkëpunëtorët tjerë për kryerjen e veprës penale. Shtytja është ndikim psikik në kryerësin kryesor në marrjen e vendimit për kryerjen e veprës penale. Rrjedhimisht del se për të ekzistuar shtytja, është e nevojshme që kryerësi të mos ketë pasur ndërmend të kryej veprën penale, ose të mos e ketë marrë vendimin për kryerjen e veprës penale, por shtytësi me veprimet e veta ndikon në forcimin e vendimit që ai të kryej veprën penale. Shtytja mund të kryhet vetëm me dashje, që do të thotë se shtytësi duhet të jetë i vetëdijshëm se me veprimin e tij e shtytë tjetrin në kryerjen e veprës së caktuar penale. Shtytja mund të bëhet edhe nga pakujdesia, por kjo formë e shtytjes nuk është e ndëshkueshme.

³⁴ I. Elezi etj., Komentari i Kodit penal të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2006.

³⁵ I. Elezi, vep. cit. fq.183

Ndihma është forma e dytë e bashkëpunimit në kuptimin e ngushtë. Ndihma është ndërmarrje e veprimeve me të cilat një person me dashje ndihmon tjetrin të kryej vepër penale. Sipas KPRSH ndihmës konsiderohet personi që me këshilla, udhëzime, dhënie mjetesh, largim të pengesave, dhënie të premtimeve për fshehjen e veprës, kryerësit, gjurmëve apo sendeve që rrjedhin nga vepra penale, do ta ndihmojë kryerësin.

Për dallim nga shtytja, ndihma mund të ekzistojë vetëm pasi personi tjetër ka vendosur të kryej veprën penale, në të kundërtën veprimet do të konsiderohen si shtytje. Ndihma mund të kryhet në mënyrë fizike dhe psikike. Si ndihmë fizike mund të konsiderohet vënia apo dhënia në diskonim kryerësit mjetet për kryerjen e veprës penale apo mënjanimi i pengesave për kryerjen e veprës penale, kurse si ndihmë psikike konsiderohet dhënia e këshillave apo udhëzimeve si të kryhet vepra penale dhe premtimi se do ta fsheh veprën penale, kryerësin apo gjurmët e veprës penale.

Ndihma e pasuksesshme ekziston atëherë kur personi që i është dhënë ndihma nuk e ka kryer veprën penale ose nuk ka tentuar ta kryej, apo nuk i ka ndërmarrë veprimet përgatitore të cilat janë të ndëshkueshme. Ndihma e pasuksesshme do të ekzistojë edhe atëherë kur kryerësi nuk e ka shfrytëzuar ndihmën e tjetrit për kryerjen e veprës penale, por e ka kryer veprën pavarësisht nga veprimet e ndihmësit.

KAPITULLI I DYTË

KARAKTERISTIKAT KRIMINOLOGJIKE TË VEPRAVE PENALE –GRABITJET DHE VJEDHJET E RËNDA

1. Karakteristikat etiologjike.

Historikisht zona e Ballkanit ka shërbyer si urë lidhëse mes Evropës dhe Azisë. Si i tillë Gadishulli Ballkanik është shfrytëzuar edhe nga grupet e ndryshme kriminale si një vend tranziti për trafikim, kontrabandim mallrave të ndryshëm, lëvizje të lirë dhe zhvillim të organizatave kriminale, në drejtim të Evropës. Dukuria e krimit të organizuar në Ballkan,

është paraqitur vetëm gjatë dekadave të fundit të shekullit XX³⁶, e lidhur kjo edhe me ndryshimet e regjimeve politike të shteteve përbërëse të rajonit.

Kriza e madhe ekonomike e viteve '80 të shekullit XX që kapi ish-Jugosllavinë dhe shtetet tjera të Evropës Juglindore, të pasuara me sanksione ekonomike dhe konflikte të ndryshme politike, kanë ofruar kushte optimale për lindjen e krimit të organizuar në Ballkan. Ndërkaq, faktorët e tjerë social, ekonomik, e politik, si dhe vakumet e krijuara ligjore dhe institucionale gjatë periudhës së tranzicionit nëpër të cilën kanë kaluar shumica e shteteve të rajonit, kanë ndikuar në zhvillimin aq të shpejtë të krimit të organizuar në Ballkan, sa që për një kohë të shkurtër i gjithë rajoni i Ballkanit është shndërruar në njërën nga epiqendrat më të rëndësishme të krimit të organizuar ndërkombëtar³⁷.

Praktika ka dëshmuar se krimi i organizuar zakonisht vepron në vende të favorshme për zhvillimin e tij. Së pari, është pozicioni gjeografik i favorshëm, që ndikon kryesisht nëaktivitetin e tij. Ballkani ka vendndodhje strategjike për grupet kriminale që e përdorin atë si tranzit, për të kaluar më pas në tregun e madh dhe fitimprurës të Evropës. Më pas, ndër faktorë të tjerë renditen, qeverisja e dobët dhe e korruptuar, si dhe ekonomia e dobët.

Ndër zonat strategjike të veprimit të organizatave kriminale mund të përmendim, zonën kufitare ndërmjet Malit të Zi dhe Kosovës që quhet Kulla, ku vërehet një numër në rritje i aktiviteteve kriminale, duke nisur nga trafiku i drogës apo kontrabanda e cigareve ndërmjet këtyre dy vendeve. Tjetër zonë është kufiri ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë, e cila shërben për kalimin e aktivitetit kriminal në Greqi dhe Bullgari. Është shumë e lehtë të trafikosh kanabis nga njëri shtet tek tjetri sepse nuk ka shumë kontroll policor dhe nga ana tjetër policitë nuk janë të pajisura me teknologjitë më të fundit që mund t'u mundësojnë gjurmimin e drogave. Gjithashtu është i pranishëm edhe korrupsioni në radhët e forcave policore dhe një pjesë e konsiderueshme e lehtësirave që u krijojnë këtyre veprimtarive kriminale mundësohen edhe nga korrupsioni.

Përveç zonave problematike, përmendet edhe veriu i Kosovës. Ajo është një zonë gri ku kryhen të gjithë llojet e kontrabandës dhe grupet kriminale shqiptare me ato serbe kanë një

³⁶<http://ëëë.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/sq/features/setimes/features/2011/11/30/feature-01>

³⁷<http://ëëë.etcgraz.at/cms/fileadmin/>

bashkëpunim shumë të ngushtë. Ndër veprat penale më të shpeshta, të kryera në këto vende strategjike mund të përmendim: tregtim karburanti, vjedhje banesash, tregëtim cigaresh dhe lëndësh narkotike. Duhet theksuar se në raste të tilla, krimi i organizuar i eleminon divergjencat etnike dhe demografike, duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet tyre.

1.1. Faktorët dhe shkaqet për dukurinë e paraqitjes së delikteve të pronës, me qasje të veçantë dhe përkushtim të grabitjeve dhe vjedhjeve të rënda.

Në këtë pikë do të ndalemi gjerësisht në faktorët kryesorë që kanë ndikuar në lindjen dhe zhvillimin e krimit të organizuar fillimisht në Ballkan dhe mëpas konkretisht në zonën e Maqedonisë, të cilat janë:

1. Pozita gjeografike.

Përmes Gadishullit Ballkanik kalojnë rrugët më të shkurtra që lidhin Evropën me Lindjen dhe Azinë. Kjo pozitë gjeografike, më tepër se çdo faktor tjetër historik, nacional ose kulturor, ka ndikuar në ndërtimin e “Rrugës së Ballkanit” për zhvillimin e kontrabanës së personave, mallrave të ndryshëm, qofshin këto edhe të vjedhur, në drejtimin Lindje - Përendim dhe anasjelltas.

2. Rruga e Ballkanit.

Njëra prej rrugëve kryesore për trafikimin e drogës në drejtim të Evropës, është e ashtuquajtura “Rruga e Ballkanit”. Sipas agjencive ndërkombëtare për luftimin e krimit të organizuar³⁸, “Rruga e Ballkanit” ka filluar të shfrytëzohet gjatë viteve ‘70-të shekullit XX. Përparësit gjeopolitike që ofronte Ballkani, kanë ndikuar që pas dhjetë viteve kjo rrugë të behët njëra prej më të njohurave në botë për trafikimin e qënieve njerëzore, kontrabandimin e drogës në drejtim të Evropës³⁹, si dhe për levizjen e lirë të individëve, të cilët kryejnë vepra penale nga një vend në tjetrin.

³⁸(Interpolit, Europolit dhe Agjencionit për Monitorim Global të Drogës me seli në Paris /*Observatoire Geopolitique Des Drogues*)

³⁹ UNODC, The Global Afghan Opium Trade, A Threat Assessment, 2011.

Kështu sipas Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM), përmes rrugëve të ndryshme të Ballkanit në drejtim të Evropës trafikohen çdo vit rreth 400.000 gra. Gjithashtu edhe përmasat e trafikimit të drogës përmes “Rrugës së Ballkanit” janë shqetësuese. Rrugët kryesore, të cilat ndiqen për zhvillimin e aktiviteve kriminale kryesisht përmes:

- “Rrugës Klasike”, që fillon në Turqi dhe kalon përmes Bullgarisë, Maqedonisë, Kosovës, Serbisë, Bosnjës dhe Kroacisë në drejtim të Bashkimit Evropian;
- “Rrugës Veriore”, që poashtu fillon në Turqi dhe kalon përmes Detit të Zi dhe Ukrainës ose Bullgarisë, Rumanisë, Hungarisë në drejtim të Austrisë dhe Sllovakisë, dhe;
- “Rrugës Jugore”, që kalon përmes Greqisë, Maqedonisë dhe Shqipërisë në drejtim të Italisë⁴⁰.

Një përfitim i tillë material, ka ndikuar në rritjen numrit të krimeve dhe shkallës së korrupsionit në disa shtete të Ballkanit, si dhe në fuqizimin e grupeve rajonale të krimit të organizuar deri në atë shkallë sa të operojnë edhe në nivel global. Shëmbull karakteristik në këtë drejtim e paraqet konfiskimi i 486 kg kokainë me origjinë nga Venezuela, në vendkalimin kufitarë Kosovë - Maqedoni⁴¹.

3. Liberalizimi jugosllav. Gjatë fundit të viteve të 70-a të shek. XX, Jugosllavia kishte instaluar një regjim relativisht liberal të lëvizjes së personave dhe mallrave. Ndërkaq në të gjitha shtetet tjera diktatoriale të rajonit, lëvizjet e tilla ishin të kufizuara dhe kontrolloheshin në mënyrë rigoroze. Padyshim se një liberalizim i tillë ekonomik dhe përparësitë tjera gjeopolitike që kishte ofruar shteti jugosllav, në krahasim me shtetet tjera të rajonit, kishte ndikuar në favorizimin e Rrugës së Ballkanit për trafikimin dhe kontrabandimin e mallrave të ndryshëm në drejtim të Evropës dhe anasjelltas.

⁴⁰http://ëëë.bmlv.gv.at/pdf_pool/publikationen/crime_baghd.pdf

⁴¹ Strategjia lokale dhe Plani aksional për droga në Qytetin e Shkupit 2008 – 2013, Shkup 2008.

4. **Kriza ekonomike.** Gjatë dekadave fundit të shek. XX, në ish- Jugosllavinë dhe shtetet tjera socialiste një krizë e madhe ekonomike kishte shkaktuar rënien drastike të ekonomisë dhe rritjen radikale të inflacionit dhe të papunësisë. Këto kriza ekonomike kishin shkaktuar edhe tensione të ashpra politike kryesisht në mes republikave të ndryshme. Në rrethana të tilla të karakterizuara edhe me dobësimin serioz të institucioneve të shtetit, në tërë rajonin e Evropës Juglindore ishin paraqitur grupe të personave që ushtronin veprimtari të organizuar kriminale, si trafikim me persona, kontrabandim me drogë, vjedhje, falsifikime, mashtrime financiare, etj.
5. **Korrupsioni.** Kriza ekonomike, tensionet politike dhe dobësimi i organeve shtetërore, kishin mundësuar zhvillimin e korrupsionit në të gjitha shtetet e Evropës Juglindore. Zyrtarët e këtyre shteteve, të zhgënjyer nga ideologjia komuniste dhe të demoralizuar nga pagat e ulëta, nuk vijonin më interesin publik por synimin e tyre për pasurim të shpejtë dhe të kundërligjshëm. Kështu përmes korrupsionit u krijuan rrjete të paligjshme të kontakteve dhe të ndikimeve në mes zyrtarëve shtetërorë, kryesisht nga shërbimet doganore, policia, administrata tatimore, shëndetësia, arsimit etj., dhe strukturave kriminale, që padyshim kanë ndikuar në rritjen e veprave të rënda penale dhe zhvillimin e krimit të organizuar në Ballkan.
6. **Periudha e tranzicionit.** Shkatërrimi i ish-Jugosllavisë dhe rënia e regjimit socialist në Shqipëri dhe vende tjera të ish-blokut socialist, shënuan fillimin e periudhës së tranzicionit. Kjo periudhë nënkupton fillimin e ndryshimit të madh strukturor dhe kalimin e shoqërive nga rregullimi shtetëror socialist, në atë demokratik. Kjo periudhë nënkupton edhe transformim radikal të të gjitha strukturave shtetërore, si dhe mungesën e institucioneve të konsoliduara. Gjatë kësaj periudhe të transformimeve të mëdha ekonomike, juridike dhe politike, u paraqitën edhe vakuume ligjore dhe institucionale që mundësuan zhvillimin e organizuar të veprimtarive të ndryshme kriminale në shumë shtete të Ballkanit.

Faktorët që kanë ndikuar në rritjen e vjedhjeve në zonën e Maqedonisë së Veriut, mund të përmendim:

- **pozita gjeografike** si korridor për tregtinë e ligjshme dhe të paligjshme;
- **profili social-demografik** me popullsi të re dhe nivel të lartë papunësie;
- **ekonomi informale masive** që lejojnë kalimin e prurjeve të paligjshme;
- **dobësi në qeverisje**, e cila shfaq problematika me konsolidimin e saj;
- nivele të larta **korrupsioni** në të gjitha strukturat shtetërore;
- **procese demokratike të kompromentuara nga identitete politike të dobëta të partive kryesore**, dhe **kontroll i varfër** mbi financimet politike;
- **hapësirë gjithnjë e më e kufizuar** për zërin dhe opinionin e medias së pavarur dhe shoqërisë civile;
- **problemet sociale** dhe pasojat që vijnë prej tyre, i kanë çuar të rinjtë shqiptarë në Maqedoni drejt vjedhjeve;
- **mungesa e jetës kulturore** në vend dhe **ekzistenca e biznesve shumë të vogla** që mund të sigurojnë vetëm kushtet për mbijetesë dhe jo mundësi zhvillimi për vendin, apo punësimi për të rinjtë;
- **mungesa e institucioneve** të posaçme kontrolluese në provinca;
- **mungesa e industrisë** dhe një vend pa industri dhe ekonomi, nuk mund të ketë as zhvillim dhe as prodhim. Pa pasur prodhim një vend, rrjedhimisht sjell varfëri dhe probleme sociale. Pjesë e problemeve sociale janë edhe dukuritë kontrakulturore, siç janë: vrasjet, vjedhjet, zënkat, rrahjet, narkomania, shkurorëzimet, prostitucioni, etj;
- pjesë e pandarë e papunësisë janë edhe **traumat shpirtërore**, rënia e moralit, thyerja e dinjitetit, cenimi i integritetit, cenimi i personalitetit, të cilat sjellin padiskutim edhe kryerjen e veprave penale;
- **mungesa e institucioneve shoqërore** dhe atyre kulturore, të cilat duhet të ishin në funksion të shoqërisë dhe duhet të siguronin mundësi punësimi për të rinj të arsimuar;

- **mungesa e jetës kulturore** në Maqedoni. Në to s'ka as biblioteka, as librari bashkëkohore, as teatër dhe as kinema dhe mungesa e tyre, domosdoshmërisht të çon në kryerje veprash penale të rënda, apo të lehta;
- **faktori politik** shqiptar në Maqedoni, ka pasur rol teatral dhe s'ka pasur kurrfarë ndikimi në proceset politike dhe ekonomike të vendit;
- **hezitimi i organeve shtetërore.** Në disa raste tjera, organet shtetërore, përkatësisht personat e ndryshëm zyrtarë kanë ngurruar të përballën me luftën kundër krimit të organizuar për shkaqe të tilla si:
 - ✚ Frika e shkaktuara nga kërcënimet e ndryshme;
 - ✚ Mungesa e motivit, kryesisht për shkak të pasigurisë sociale dhe pagave të ulëta, dhe;
 - ✚ Pasigurisë profesionale. Një numër i personave zyrtarë janë punësuar sipas lidhjeve familjare ose ndikimeve politike, e jo sipas vlerave të tyre të mirëfillta profesionale. Këta persona janë të karakterizuar me mundësin e influencimit të lehtë të tyre nga ndikimet e jashtme, të cilat trajtohen edhe si ndërhyrje në punët e policisë ose në sistemin e drejtësisë.
- **përfshirja e personave zyrtarë në aktivitete të jashtëligjshme.** Në vende të tilla në tranzicion si Maqedonia, institucionet shtetërore kanë dëshmuar se janë të paafta për luftimin e suksesshëm të krimit të organizuar dhe të korrupsionit edhe nga fakti se disa struktura të tyre zyrtare ose politike janë të përfshira, ose përfitojnë në mënyra të ndryshme nga aktivitetet kriminale. Kjo dukuri po ndikon në zhvillimin relativisht të lirë dhe të papenguar të formave më të rënda të krimit të organizuar ekonomik, vjedhjeve, piraterisë, apo pastrimit të parave.
- **mungesa e transparencës dhe mungesa e bashkëpunimit** në mes institucioneve vendore dhe atyre ndërkombëtare. Në disa raste edhe mosbashkëpunimi në mes institucioneve vendore dhe atyre ndërkombëtare, e sidomos dukuria e jo transparencës së punës së institucioneve ndërkombëtare, po reflektohet si hendikep në kryerjen e suksesshme të misionit të tyre primarë: luftimin e krimit të organizuar. Kjo jo

transparencë padyshim se ka ndikuar edhe në krijimin e një klime të mosbesimit dhe të një ambienti ku institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare e fajësojnë njëri-tjetrin për gabimet ose mospunuesit e tyre në luftë kundër krimit të organizuar.

Në realitet, që nga viti 1999, me ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare, shtetet e rajonit kanë ratifikuar Iniciativën për Bashkëpunim në Evropën Juglindore, duke themeluar edhe Qendrën SECI për bashkëpunim në fushën e policisë dhe doganore dhe Qendrën SELEC për bashkëpunim juridik,⁴² dhe kanë ratifikuar Konventën për Bashkëpunim Policor në Evropën Juglindore.⁴³ Gjithashtu këto shtete kanë ratifikuar edhe Konventën e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, Konventën e OKB-së kundër Korrupsionit dhe Protokollin e Dytë Plotësues të Konventës Evropiane për Ndihmë Reciproke në Çështjet Penale. Pavarësisht këtyre obligimeve të shteteve kontraktuese për bashkëpunim të gjithanshëm në luftë kundër krimit të organizuar, në rast nevojë edhe përmes zhvillimit të hetimeve të ndërsjella dhe krijimin e organeve të përbashkëta hetimore, praktikat e deritanishme kanë dëshmuar se vëndosja e një bashkëpunimi efikas dhe kualitativ në mes shteteve të rajonit është ende një dëshirë e jo realitet.

Përderisa kufinjët shtetrorë, regjimi i vizave dhe barrierat e ndryshme doganore nuk kanë shërbyer si pengesa për zhvillimin e krimit të organizuar në Ballkan, atëherë ato nuk duhet të paraqesin as pengesa për bashkëpunimin në mes shteteve të rajonit në luftimin e krimit të organizuar dhe dukurive tjera negative

2. Karakteristikat fenomenologjike të veprave penale – grabitjet dhe vjedhjet e rënda.

⁴²Qendra SECI është organizatë operative rajonale në Evropën Juglindore e themeluar në vitin 1999, për fuqizimin dhe mundësimin e bashkëpunimit të autoriteteve policore dhe doganore të vendeve anëtare në luftën kundër krimit ndërkufitar. Vendet anëtare të Qendrës SECI janë Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Greqia, Hungaria, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Rumania, Serbia, Sllovenia dhe Turqia.
<http://ëëë.unodc.org/documents/southeasterneurope/Guidelines-Albanian.pdf>

⁴³Më 5 maj 2006, gjatë presidencës austriake të BE-së, ministrat e punëve të brendshme të Shqipërisë, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Rumania dhe Serbia, kanë nënshkruar në Vjenë, Konventën për Bashkëpunim Policor për Evropën Juglindore.

Trekëndëshi i rajonit ku takohen Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Serbia që banohet kryesisht nga shqiptarë etnikë vuan nga prapambetja ekonomike, paqëndrueshmëria, kufij të papërcaktuar mirë dhe qeverisje të dobët, duke u bërë pre e lehtë për krimin e organizuar. Qytetet kryesore të këtij rajoni janë Kumanova dhe Tetova⁴⁴, që llogaritet të kenë respektivisht popullsi prej 109,000¹² dhe 92,000 banorësh.

Ky rajon ka në përgjithësi një terren malor dhe për pasojë edhe kontrolli i kufijve, përveç pikave zyrtare të kalimit të kufirit është goxha i vështirë. Tetova, Kumanova dhe Lipkovo⁴⁵, kanë nivelin më të lartë të papunësisë⁴⁶ në vend dhe janë zona të varfra. Të rinjtë e kësaj zone mundohen të emigrojnë⁴⁷, ose rrezikojnë të bëhen pre e lehtë e rekrutimeve në grupe kriminale, apo të armatosura për kryerjen e veprimtarive të mëjetshme kriminale.

Gjatë periudhës së Jugosllavisë, nuk kishte kufij shtetërorë midis bashkësive të shqiptarëve etnikë që jetonin në Maqedoninë e Veriut, luginën e Preshevës në jug të Serbisë dhe jugut të Kosovës. Megjithëse rajoni tani ndahet në tre shtete, familjet e kanë për zakon të kalojnë nga shteti në shtet për të takuar të afërmit e tyre. Këto lidhje fafësnore, dhe prirjet për të kaluar shpesh kufirin, nganjëherë e bëjnë më të lehtë përfshirjen në kontrabandë. Thuhet se gjatë vitive '90 në këtë rajon ka patur aktivitet të dendur kontrabande (veçanërisht karburant) drejt Serbisë dhe Malit të Zi, gjatë periudhës së embargos.

Në ditët e sotme, mallrat kryesore kontrabandë nëpër këtë rajon besohet se janë bagëti, mallra ushqimore, flori, cigare, dhe droga. Trafiku i drogës duket se përqendohet kryesisht tek kanabisi nga Shqipëria, që kalon nëpër Kosovë apo Maqedoninë e Veriut, dhe më pas drejt luginës së Preshevës, për në Serbi, Bullgari dhe Greqi; heroinë nga Turqia nëpërmjet Bullgarisë; dhe kokainë nga Serbia. Mendohet se në këtë zonë përpunohet dhe paketohet edhe heroina. Në dhjetor 2017, 110 kilogramë heroinë u konfiskuan në një autobus që nisej nga Lugina e Preshevës për në Zvicër. Në tetor 2018, policia shqiptare bastisi një laborator

⁴⁴ Kumanova ndodhet në kryqëzimin e autostradave nga Selaniku për në Beograd (apo verilindje të Kosovës), dhe nga Shkupi në Kyustendil (Bullgari).

⁴⁵ Me popullsi prej 30,000 banorësh.

⁴⁶ Rreth 58% e popullsisë në vend.

⁴⁷ Veçanërisht që nga momenti kur BE liberalizoi vizat për Maqedoninë e Veriut në vitin 2010.

heroine në zonën malore të Hasit (pranë Kukësit), dhe gjeti morfinë dhe materiale për përpunimin e drogës, që vinin nga Turqia nëpërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës.

Po kështu, ka të dhëna që sugjerojnë se në këtë rajon prodhohen edhe droga sintetike. Në dhjetor 2017, u zbulua një laborator i fshehtë në një fshat pranë Tetovës, dhe u konfiskuan 300 kilogramë pilula amfetamine – sasia më e madhe e drogave sintetike të kapura ndonjëherë në Evropën juglindore. Milan Zarubica – që u quajt nga ministria e punëve të brendshme të Serbisë si “prodhuesi më i madh i drogave sintetike” në rajon –u arrestua në Serbi, pas një operacioni të përbashkët me policinë e Maqedonisë së Veriut.

Ky rajon është gjithashtu një zonë problematike për trafikimin e qenieve njerëzore. Që nga viti 2014, kufiri verior i Maqedonisë së Veriut – veçanërisht fshatrat Vaksince dhe Lojane – janë kthyer në një korridor famëkeq për trafikimin e emigrantëve. Emigrantët tregojnë se janë shfrytëzuar dhe keqtrajtuar nga banorët vendas kur shkonin të luteshin për ushqim dhe strehim. Ka edhe pretendime se emigrantëve u janë shitur pasaporta të Maqedonisë së Veriut (megjithëse nuk është e qartë se kush ia ka shitur).

Gjatë 20 viteve të fundit, ky rajon është bërë dëshmitar i një sërë konfliktesh serioze. Në vitin 1999, gjatë krizës në Kosovë, një numër i madh shqiptarësh të Kosovës kaluan si refugjatë në Maqedoninë e Veriut. Tensionet ndëretnike erdhën duke u shtuar, në një kohë kur shqiptarët bënë thirrje për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të pakicave etnike. Një krizë tjetër nisi edhe në krahun serb të kufirit, kur ish-luftëtarë të UÇK-së themluan Ushtrinë Çlirimtare të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit (UÇPMB), që bënte thirrje për shkëputjen nga Serbia të këtyre tre bashkive me popullsi shqiptare, dhe bashkimin e tyre me Kosovën. Për rreth dy vjet pati edhe përplasje të armatosura sporadike, veçanërisht rreth zonës së Bujanovcit.

Si pasojë e këtyre incidenteve të dhunshme, rajoni i Kumanovës ka patur probleme në thithjen e investimeve, dhe thuhet se merr shumë pak mbështetje edhe nga shteti. Kontrolli i kufirit në këtë rajon është i dobët, madje edhe pikat zyrtare të kalimit kufitar nuk janë të sigurta, si pasojë e zyrtarëve të korruptuar që kanë lidhje me partitë politike.

Kontrabanda zhvillohet rëndom duke kaluar kufirin jeshil midis Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë, pranë pikës së kalimit kufitar Tabanovce / Preshevë, që ndodhet pranë fshatit Lojane. Thuhet se në ditët e sotme ka një numër grupesh kriminale (rreth tetë grupe kryesore) që kryejnë aktivitet kriminal në rajonin e Tetovës. Këto grupe janë të ndërlidhura fort me komunitetet e zonës, dhe shumë nga pjesëtarët e tyre kanë hapur bare dhe restorante, dhe disa prej tyre kanë lidhje edhe me rrjete kriminale jashtë shtetit. Në këtë lloj atmosfere, paqëndrueshmëria, prapambetja, madje edhe krizat do të vazhdojnë të jenë diçka normale për këtë zonë.

Përmasat e zhvillimit të krimit të organizuar, kanë ndikuar që rajoni i Ballkanit, gjatë viteve të fundit, të mos trajtohet më vetëm si vend transiti por gjithnjë e më tepër të manifestohet edhe si vend destinimi, deponimi dhe trafikimi me drogë, si vend trafikimi me qenie njerëzore, si vend kontrabandimi me armë, si vend për pastrim parash dhe si vend për kryerjen e formave të ndryshme të krimit të organizuar ekonomik dhe atij financiar etj⁴⁸.

Shqetësues është fakti se tregjet e brendshme të drogave në disa shtete të Ballkanit, janë duke u rritur me shpejtësi, bashkë me numrin e përdoruesve të drogës, të cilët gjithnjë e më tepër po paraqitën si përdorues të shumëfishtë droge⁴⁹.

Sipas disa analizave, shtetet e Ballkanit gjithnjë e më tepër po paraqitën si vende ku kultivohet droga, si vende ku prodhohet marijuana dhe vaji i hashashit dhe si vende ku tregtohet dhe abuzohet me të gjitha llojet e drogave⁵⁰. Ndërsa sipas Evropolit, rajoni dominant për prodhimin e hashashit që furnizon tregun e Bashkimit Evropian është Shqipëria, e pasuar nga Serbia, Bullgaria dhe Kosova⁵¹. Sipas këtij burimi, kanabisi i kultivuar në Shqipëri, Maqedoni dhe rajonin e Kosovës jo vetëm që shpërndahet në Greqi, Itali, Slloveni, Hungari por edhe trafikohet në Turqi, me qëllim të shkëmbimit të saj me heroine.

⁴⁸ <http://ëëë.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/sq/features/setimes/features/2010/03/03/feature-01>

⁴⁹ http://ëëë.coe.int/t/dghl/cooperation/economiccrime/organisedcrime/projects/carpo/Pctc_2006_20alb.pdf

⁵⁰ Qaja, E., Stigmatizimi dhe politikat anti drogë në Shqipëri, <http://drogriporter.hu/files/eudrugpolicy/Stigmatizimi.pdf>

⁵¹ <http://ëëë.mapo.al/2013/02/01/raporti-grupet-shqiptare-rol-kyc-ne-trafikun-e-heroines-bashke-me-turqit/>

Gjithashtu duhët theksuar faktin shqetësues se përgjatë Ballkanit nuk kalojnë vetëm drogat e prodhuara në Afganistan, Iran, Turqi, Shqipëri dhe Maqedoni në drejtim të Bashkimit Evropian, por përmes Rrugës së Ballkanit në drejtim të Turqisë dhe shteteve tjera të lindjes kontrabandohët edhe Anhidriti Acetik që prodhohet në Bashkimin Evropian dhe përdorët për prodhimin e heroinës⁵².

Krimi i organizuar në Ballkanik ka mundur të zhvillohet në përmasa të tilla pa vendosjen e një bashkëpunimi në mes grupeve rajonale të krimit të organizuar. Këto grupe gjithnjë e më të sofistikuar kriminale, në të gjitha shtetet e Ballkanit janë të karakterizuara me aftësin e tyre për të bashkëpunuar me njëri tjetrin dhe për tu përshtatur sipas interesit të tyre kriminal ndaj çdo rrethane të re shoqërore.

Kjo dëshmojë edhe nga fakti se zhvillimi i luftërave të fundit ndëretnike në ish Jugosllavi ose i konflikteve të armatosura në Moldavi, Rumani dhe Shqipëri, nuk ka ndikuar në ndërprerjen e bashkëpunimit në mes grupeve kriminale në rajon pavarësisht përkatësive të tyre “të konfrontuara” etnike ose fetare. Në realitet këto grupe kriminale edhe përkundër retorikës së tyre të rëndë por formale nacionaliste, gjithmonë kanë bashkëpunuar me njëri tjetrin në fushën e trafikimit me drogë, trafikimit me qenie njerëzore, kontrabandimit me automjete të vjedhura, kontrabandimit me cigare, kontrabandimit me armë, trafikimit me derivate të naftës dhe pastrim të parave.

KAPITULLI I TRETË

KARAKTERISTIKAT KRIMINALISTIKE TË VEPRAVE PENALE – GRABITJET DHE VJEDHJET E RËNDA, ME SHQYRTIM TË VEÇANTË TË KËTYRE VEPRAVE TË KRYERA NË PJESËN PERËNDIMORE TË RMV 2013-2019

1. Mënyra e krerjes të veprave penale - grabitje dhe vjedhje të rënda

⁵² Europol Jahresbericht 2011, Den Hag 2012, f. 34.

1.1. Mjetet që përdoren për kryerjen e grabitjeve dhe vjedhjeve të rënda (instrumentum operandi).

Në këtë nënçështje po jap shembuj të disa rasteve të vjedhjeve që kanë ndodhur përgjatë periudhës 2013-2019 në RMV, për të kuptuar më tej edhe mënyrën e realizimit të tyre.

- ❖ *Në vitin 2018, një person i panjohur për festat e Pashkëve, ka kryer vjedhje në hapësirat e Kryqit të Kuq në Republikën e Maqedonisë, në Shkup, ku janë vjedhur gjithsej 121.000 denarë dhe 320 euro⁵³.*
- ❖ Për dallim nga viti 2018, gjatë gjatë vitit 2019 janë përgjysmuar vjedhjet e automobilave në Maqedoninë e Veriut⁵⁴. Statistikat e policisë së shtetit në RMV tregojnë se gjatë 2018, janë regjistruar gati 500 vjedhje të automobilave. Ndërkohë, të dhënat e këtij viti flasin se në territorin e RMV-së, nga janari e deri në shtator janë vjedhur 261 automobila. Këto të dhënat të publikuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, vërtetohen edhe nga EUROSTA-ti, të cilët thonë se edhe në nivel të shteteve të Bashkimit Evropian, është shënuar rënie e këtij lloji të krimit⁵⁵. Sipas tyre, në nëntë vitet e fundit të dhënat flasin se për 29 për qind ka më pak vjedhje të automobilave.
- ❖ Qytetarët e Maqedonisë së Veriut, jo rrallë herë janë ballafaquar me vjedhjet e rënda. Në shënjestër të autorëve të këtyre veprave, zakonisht kanë qenë, por edhe vazhdojnë të jenë automobilat që kushtojnë shtrenjtë. Sado që mendohet se grupet kriminele veprojnë në mënyrë të organizuar me vjedhjen e automobilave, kjo në praktikë nuk është edhe aq e dëshmuar. Viteve të kaluara disa prej vjedhjeve të automobilave ndodhën në bulevardin “Aradhet Partizane”, në Shkup. Në këto raste autorët kanë vepruar gjatë kohës kur pronarët e veturave, janë treguar neglizhent dhe i kanë lënë çelësat brenda në vetura, dhe janë larguar me nxitim për të paguar ndonjë faturë, apo për të kryer ndonjë shërbim tjetër në bankë.

⁵³ Botuar në 11 prill 2018 në Gazetën “Bota Sot”.

⁵⁴ Botuar në 23.12.2019 në Gazetën “Bota Sot”.

⁵⁵ Botuar në “Gazeta Koha”.

- ❖ Lokacione tjera atraktive për vjedhjen e automobilave janë parkingjet publike, respektivisht viktima të këtyre ndodhjeve shpesh herë janë edhe shtetas të huaj.
- ❖ Autoritetet policore kanë realizuar një varg aksionesh për arrestimin e autorëve të specializuar për vjedhjen e veturave. Disa prej këtyre aksioneve, të ndërmarra në vitet 2013 dhe 2017, u realizuan në fshatin Gërçec, rrethinë e Shkupit, ku mbetën të arrestuar katër persona, të akuzuar se kanë vjedhur vetura dhe më pas për kthimin e automobilave, në mënyra të ndryshme i kanë shantazhuar pronarët e veturave. Në disa prej rasteve ka pasur edhe kërcënime me jetë që ngjarjet mos të denoncohet në polici.

1.2. Mënyra e kryerjes së grabitjeve, të kryera në pjesën perëndimore të RMV gjatë periudhës kohore 2013-2019.

Në vjedhjet e realizuara nga grupe kriminale, të cilët më së shumti realizojnë forma grabitjesh, ka disa elementë të përbashkët në mekanizmin e kryerjes së tyre, të tilla, si:

- Përdorimi për lëvizje i mjeteve të vjedhura, gjatë momentit që drejtuesit e tyre kanë ndaluar për pushim dhe çelësat ndodhen në mjet;
- Mjetin e fshehin, duke i ndërruar targat në disa raste dhe në disa të tjera kanë përdorur po targat orgjinale. Kopjojnë targat e një mjeti tjetër të ngjashëm me atë të vjedhur;
- Djegie e mjetit që kanë përdorur për të lëvizur gjatë dhe pas vjedhjes, si edhe largimi me mjete të tjera motorike;
- Mënyra e realizimit të vjedhjes, ku njëri prej autorëve qëndron tek dera e objektit që po kryhet vjedhja si roje nëse do të afrohej policia. Ky person është i gjatë dhe mban gjithmonë automatik në dorë;
- Përdorimi i maskave, dorezave ose dhe veshje me mbishkrimin policia;
- Ndarja e roleve gjatë realizimit të vjedhjes; dikush do të vjedh mjetin, dikush do të gjej armët, veshjet apo do të kryhej vjedhje;

- Personat që kanë realizuar vjedhjet kanë karakteristika fizike të përbashkëta.
- Objektet e vjedhura janë kryesisht argjendari, dyqane që qarkullojnë vlera të lata parash çdo ditë, apo makina.

1.3. Mënyra e kryerjes së vjedhjeve të rënda, të kryera në pjesën perëndimore të RMV gjatë periudhës kohore 2013-2019.

Kriminaliteti në Maqedoni⁵⁶ shënon rritje. Ndërkaq, ekspertët konsiderojnë se nevojiten ndryshime të mëdha në politikën e sigurisë, me qëllim që qytetarët të ndjehen më të sigurt në jetën e tyre.

Vrasje, vjedhje dhe të shtëna armësh ndodhin në periudhën e fundit në Maqedoni, madje edhe në orët e ditës. Rasti i fundit është vjedhja e 50 mijë eurove nga banka ‘Pro-credit’ në Shkup, por policia nuk jep detaje rreth hetimit të rastit, sepse, sipas saj, çdo kumtim i detajeve do të jetë në favor të hajdutëve.

“Politika e sigurisë në Maqedoni ka elemente, të cilat qytetarin e vënë në dilemë se sa është i sigurt në shtëpinë e tij, sa është i lirë dhe sa ka të drejtë për një ekzistencë sociale-ekonomike dhe të tjera. Në Republikën e Maqedonisë, Qeveria e tashmë duhet të bëjë reformë të re, e cila u ofron një kuptim politikave të sigurisë në të gjitha aspektet, që qytetari të mos ketë dyshim se sa është pjesë e ligjit dhe e shtetit”.

Sipas tij, rritja e kriminalitetit është pasojë e gjendjes së vështirë ekonomike dhe sociale të qytetarëve.

Ndërsa, profesori Vlladimir Pivovarov pohon se problem serioz në Maqedoni është posedimi i armëve jolegale. Sipas tij, si pasojë e trazirave në Shqipëri në vitin 1997, në vendet e rajonit kanë qenë të shpërndara rreth 900 mijë armë, një pjesë e të cilave edhe në Maqedoni. *“Armët e tilla mund të përdoren për masa më radikale, siç është rrëzimi i sistemit, rrëzimi i dhunshëm i rendit kushtetues në një shtet. Domethënë, problemi nuk është vetëm te vjedhjet, por problemin duhet ta shqyrtojmë shumë më gjerë, siç është kërcënimi i ekzistimit të shtetit”.*

⁵⁶ Botuar në Gazetën “Radio e Lirë”.

Gjurmimi dhe identifikimi i aseteve përfshin procesin e hetimit penal dhe financiar për të gjetur pasuritë ose vendndodhjen e tyre, qoftë brenda juridiksionit ku po kryen hetimet penale, ose në një juridiksion tjetër që do të përfshinte një kërkesë ndërkombëtare për të gjurmuar asetet. Identifikimi i aseteve synon të zbulojë pronarin ose kontrolluesin e pasurisë. Pas gjurmimit dhe identifikimit të asetit dhe sapo çështja të kalojë në fazën e hapur të hetimit, asetit duhet t'i nënshtrohet bllokimit, sekuestrimit ose ndalimit, me qëllim që ta ndalojë të lëvizë në periudhën para çdo vendimi të formës së prerë, në pritje të konfiskimit. Nëse asetet nuk janë të bllokuara apo të sekuestruara, autori i dyshuar i veprës mund ta lëvizë asetin në një përpjekje për ta fshehur ose shitur.

Bllokimi dhe sekuestrimi zbatohen me urdhër të gjykatës. Kur një aset i nënshtrohet një urdhri bllokimi, mbetet aty ku është, për shembull, një llogari bankare do të ngrihej. Kur një aset i nënshtrohet një urdhri sekuestrimi, ai kalon në zotërim të shtetit, për shembull një makinë mund të sekuestrohet. Bllokimi dhe Sekuestrimi përkufizohen gjithashtu si "sekuestro". Termi ndalim përdoret për të përshkruar ndalimin e përkohshëm të transferimit, konvertimit, shitjes ose lëvizjes së pasurisë në pronësi të një personi të caktuar, gjithashtu nëpërmjet një urdhri të gjykatës. Në këtë rast, asetit zakonisht mbetet në pronësi të pronarit. Një urdhër ndalimi vendoset për një individ dhe jo aset, megjithëse pasuria do të përshkruhet si "e ndaluar" ose subjekt i një urdhri ndalimi.

"Bllokimi" ose "sekuestrimi" nënkupton ndalimin e përkohshëm të transferimit, konvertimit, shitjes ose lëvizjes së pasurisë ose marrjen e përkohshme të kujdestarisë ose kontrollit të pasurisë me anë të një urdhri të lëshuar nga një gjykatë ose autoritet tjetër kompetent.

Prokuroria për Krime të Rënda kërkon në total dënimin me 175 vjet burg për 6 nga 11 anëtarët e bandës së "Babagyshëve", procesi për të cilin u zhvillua me gjykim të shkurtuar. Ndërkohë, për 5 të tjerët, procesi vijon me gjykim të zakonshëm.

Të gjithë personat akuzohen për veprat penale; "vjedhje me armë", "plagosje të rëndë", "mbajtje pa leje të armëve luftarake" dhe "kryerje të veprave penale në kuadër të grupit kriminal. Në bazë të hetimit, Prokuroria ka ngritur akuza për këtë grup personash për 13 episode kriminale.

Hetimi për këtë grup kriminal nisi në Prokurorinë për Krime të Rënda, në bazë të disa referimeve të Policisë së Shtetit, pas disa ngjarjeve kriminale të ndodhura në vitin 2013 dhe 2014 në Tiranë, Durrës, Laç, Fushë-Krujë dhe Kuçovë.

Prokuroria për Krime të Rënda i akuzon personat e mësipërm, si edhe të pandehurit e tjerë që po gjykohen në proces të zakonshëm, për ngjarjet si më poshtë:

Krahas vjedhjeve të mësipërme, të kryera në Shqipëri, një grup kriminal ka realizuar edhe dy vjedhje në Maqedoni:

Në datë 30.04.2014 është vjedhur argjendaria në pronësi të shtetasit R.H, ndodhur në Strugë, ku është marrë një sasi prej 5.5 kg flori. Këtë vjedhje, autorët e kanë realizuar të veshur si femra. Gjatë vjedhjes ka pasur përplasje me armë me personat e argjendarisë dhe policisë maqedonase.

Në datë 29.07.2014 është vjedhur një argjendari, ndodhur në Dibër të Madhe, ku gjatë vjedhjes, autorët kanë shkëmbyer zjarr dhe është vrarë njëri nga bashkëpunëtorët në kryerjen e kësaj vjedhjeje, shtetasi Miljan Elezi (alias Artur Tafani). Në këtë vjedhje është marrë një sasi prej 12 kg flori.

Në çdo rast, krahas personave që kanë marrë pjesë aktive në vjedhje, bashkëpunëtorët e tyre kanë kryer veprime konkrete në funksion të aktivitetit kriminal, si sigurimin armëve dhe automjeteve për realizimin e veprës penale.

2.Gjurmët

2.1 Gjurmët nga mjetet e përdorura.

Me kryerjen e një vepre penale, pra duke kryer vetë krimin, kryesi në vendin e ngjarjes formon dhe lë gjurmë të shumta materiale, disa prej të cilave janë gjurmë me origjinë njerëzore. Sa të dhëna do të lërë në vend, vetitë e tyre morfologjike dhe biologjike,

karakteristikat e identifikimit dhe më shumë varet nga shumë rrethana, por është e qartë se, pavarësisht nga të gjitha masat e marra për të parandaluar zbulimin e tij, gjurmë të shumta mbeten në vend, pra gjatë kryerjes së krimit, si në vendin e krimit, si kryesi dhe viktima ose pala e dëmtuar. Megjithëse qëllimi i kryerësve bashkëkohorë të veprave penale është që të lënë sa më pak gjurmë të jetë e mundur në kryerjen e veprave penale, veçanërisht ato të identifikimit, dhe kështu të kryejnë një “krim të përsosur”. Praktika, ka treguar që kjo nuk është e mundur, d.m.th. veprat penale gjithmonë lihen me gjurmë dhe shpesh shenja të identifikimit.

Gjatë hetimit kriminal, policia, përmes përdorimit të metodave shkencore dhe praktike të kriminalistikës, gjen të dhëna materiale që lidhen me krimin dhe autorin e krimit, në mënyrë që ti sigurojë provat. Praktika konfirmon që, pavarësisht nga fakti se autorët kujdesen të mos lënë gjurmë ose t'i heqin ato, nuk ka gjasa që ata ta bëjnë këtë me sukses plotësisht, në mënyrë që gjurmët e ndryshme materiale të mund të gjinden në vendin e ngjarjes, saktësisht duke aplikuar metoda kriminalistike-fizike dhe kimike duke përdorur shumë krime janë sqaruar dhe provuar.

Gjetja, sigurimi dhe fiksimi i gjurmëve ka dimensionin e saj kriminal-taktik dhe teknik, si dhe anën kriminale-operative që del në dritë kur ata fillojnë interpretimin, vlerësimin operativ dhe përdorimin e tyre.

Megjithëse studimi i gjurmëve materiale, d.m.th., dimensionin material i një krimi, i mundëson një hetuesi të arrijë në një të vërtetë objektive, ai gjithmonë duhet të jetë i lidhur me mënyrën taktike të sigurimit dhe fiksimit të gjurmëve dhe të shihet në kuptim të vlerës së tyre operative dhe metodës së përdorimit operativ. Dështimet që lindin në gjetjen, sigurimin dhe rregullimin e të dhënave duke përdorur taktikën kriminalistike dhe aktivitetet teknikës kriminalistike, reflektojnë drejtpërdrejt mundësinë e përdorimit të tyre operativ, i cili ka efektin e shtrembërimit të strukturës së provës materiale dhe pengimit ose parandalimit të përdorimit të tyre në procedurat penale.

Dështimet e taktikës –kriminalistike dhe teknika kriminalistike më së shpeshti ndodhin kur veprimet dhe masat kriminiko-taktike dhe teknike dhe masat dhe veprimet hetimore ndërmerren nga policia, qoftë në fazën e veprimit të vetë-iniciativës, qoftë gjatë hetimit, kur policia përpiqet të përdorë këto veprime për të formuar një bazë materiale për marrjen e një shkalle dyshimi ose dyshimi të arsyeshëm, i cili sigurisht që ka një ndikim negativ në përdorimin operativ të gjurmëve të mbledhura dhe të fiksuara.

Në shumë raste, një qasje e tillë joprofesionale kriminalo-taktike dhe teknike për gjetjen dhe fiksimin e gjurmëve e bën të pamundur marrjen e një dyshimi të arsyeshëm se një person i veçantë është kryesi i krimit ose çon në përfundimin e procedurës penale, ose lirim për shkak të mungesës së provave,

Për zbulimin e suksesshëm të gjurmëve është e nevojshme të dihet:

Cilat gjurmë janë specifike për krime të veçanta dhe ku të kërkohen ato, cilat metoda dhe mjete ndihmëse kërkohen për gjurmë dhe cilat janë gjurmët e padukshme, ku gjenden dhe si i bëjmë ato të dukshme. Duke studiuar parimet që rregullojnë procesin e gjurmëve materiale që kemi thënë më lart, ne arrijmë në njohuritë që na mundësojnë të parashikojmë ekzistencën e tyre në vende të caktuara gjatë rindërtimit mendor të ngjarjeve, si dhe të rindërtojmë ngjarjen që krijoi gjurmët e nxjerra nga gjurmët. Për të eliminuar gabimet në përpunimin kriminalistik të vendit të ngjarjes, anëtarët e grupit të hetimit duhet të jenë të vetëdijshëm për mundësitë dhe mekanizmat e shfaqjes së gjurmëve të caktuara në krime të caktuara, varësisht nga mjetet, mënyra, koha dhe vendi i ekzekutimit dhe faktet dhe rrethanat e tjera, vetitë e tyre dhe masa e mbrojtjes nga ndryshimi dhe shkatërrimi.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme nëse dihet që secila nga hartëzimet në gjurmë humbet një sasi e caktuar e informacionit nga ajo gjurmë, dhe duke zgjedhur metodën dhe mjetet më të përshtatshme për të eliminuar gjurmën, kjo humbje mund të reduktohet në një masë të tolerueshme. Sidoqoftë, nëse aplikohen metodat e gabuar ose të papërshtatshme, disa gjurmë mund të shkatërrohen përgjithmonë, që sigurisht që është një nga pikat më të afërta të

kontaktit midis mekanizmit të formimit të gjurmëve, përjashtimit dhe fiksimit të tyre, i cili duhet të konsiderohet me kujdes. Vlerësimi kriminalistiko-operativ, interpretimi dhe përdorimi i të dhënave përfshinë të gjitha llojet e të dhënave dhe fakteve që mund të japin informacione përkatëse. Nga pikëpamja e kriminalistikës operative, vlerësimi, interpretimi dhe përdorimi operativ i të dhënave nuk ka të bëjë vetëm me të dhëna materiale, por edhe me të dhëna jo-materiale, deklarata të personave dhe fakteve dhe rrethanave të tjera që mund të gjenden në vendin e ngjarjes. Kjo është shumë e rëndësishme, sepse jo çdo situatë kriminale do të jetë në gjendje të sigurojë gjurmë materiale, kështu që veprimtaria operative e policisë do të duhet të bazohet në fakte të tjera të gjetura dhe të përcaktuara në vendin e ngjarjes.

Për shkak të rëndësisë operative dhe përdorimit të të dhënave, kriminalistika operative shkon përtej qëllimit të mësimt të teknikës kriminalistike që lidhet me aspektet kriminale-teknike të vetëm me të dhëna materiale, duke pasur parasysh faktin që teknika kriminalistike merret me gjetjen dhe rregullimin e fakteve të tjera. Gjithashtu modele krahasuese neutrale, por gjurmët psikike dhe disa fakte të tjera (deklaratat e fytyrës) janë jashtë sferës së teknikës kriminalistike. Prandaj kriminalistika operative studion të gjitha faktet përkatëse që mund të gjenden në vendin e ngjarjes, ndër të cilat informacioni më i rëndësishëm sigurisht sigurohet nga të dhënat dhe objektet. Sidoqoftë, këto nuk janë të vetmet fakte të rëndësishme për mbulimin e krimit, por ato mund të përdoren gjithashtu për të mbledhur dhe përdorur disa fakte psikike që përfaqësojnë të dhëna psikike, fakte negative që në fund të fundit janë një lloj i dhënë, informacione të marra nga deklaratat që mund të jenë baza (burimi) prova personale, rrethanat e njohura për kryerësin e veprës penale dhe ndikojnë në ekzekutimin e tij më të lehtë, si dhe mostrat krahasuese neutrale që nuk përfaqësojnë të dhëna, por shërbejnë për tu krahasuar me të dhëna për qëllimin e mbledhjes së provave material.

Është e nevojshme të theksohet se gjetja dhe fiksimi i gjurmëve materiale nuk është qëllim në vetvete, por duhet të shërbejë kryesisht për qëllime operative, domethënë, gjurmët materiale marrin konfirmim adekuat dhe të duhur kriminalistiko-operativ, e cila do të rezultojë në zhvillimin e gjurmëve materiale në prova gjatë procedurës penale. Kjo është arsyeja pse përpunimi kriminalistik i skenës së krimit është vendi ku do të jetë e nevojshme t'i

përmbahen dy aspekteve themelore të fiksimit dhe sigurimit të gjurmëve materiale. E para ka të bëjë me pretendimet kriminalistike, ndërsa e dyta ka të bëjë me pretendimet penale. Kur bëhet fjalë për aspektin kriminalistik dhe / ose tekniken kriminalistike të fiksimit dhe sigurimit të gjurmëve materiale të një vepre penale, kërkesa themelore është që përveç procesverbalit, i cili është një kërkesë procedurale penale, çdo gjurmë regjistrohet në mënyrë fotografike. Për më tepër, mbajtësi i gjurmës ose gjurmët duhet gjithmonë, kur është e mundur, të lirohet dhe të ruhet në mënyrë adekuate në një laborator ose dhomë tjetër zyrtare të policisë.

Për më tepër, kur rregulloni gjurmët, është e nevojshme të zgjidhni ato metoda që lejojnë qëndrueshmëri të mjaftueshme të karakterit të fituar. Siç u tha tashmë, kërkesa themelore procedurale penale është që secila gjurmë të regjistrohet dhe të fiksohet në procesverbal. Për më tepër, duhet të tregohet kujdes kur të përcaktohen dëshmitë e identitetit të gjurmës që lidhet me gjurmën e përshkruar në procesverbal, e cila është e nevojshme për të përjashtuar mundësinë e abuzimit, manipulimeve dhe zëvendësimit të paqëllimshëm. Për të qenë në gjendje përdorimi operativ i gjurmëve që vijnë nga kryerja e krimit, është e nevojshme që ato të zbulohen në kohën e duhur dhe të jenë të sakta si duhet, ashtu edhe penalisht edhe proceduralisht. Prandaj, puna profesionale dhe ekipore e oficerëve të policisë, teknikëve forenzik dhe dëshmitarëve ekspertë gjatë kryerjes së hetimeve dhe punës operative për sqarimin dhe të provuarit e një krimi dhe shkëmbimin e mendimeve në lidhje me informacionin operativ të siguruar ose të aftë për të dhënë të dhëna të caktuara të rëndësishme.

Prandaj, duhet të përcaktohet nëse gjurma ka lidhje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me krimin e kryer, në mënyrë që të përcaktohet shkaku i shfaqjes së tij dhe lidhja shkakësore me aktin dhe pasojën e krimit. Në interpretimin dhe vlerësimin e gjurmëve dhe përdorimin e tyre operativ është e rëndësishme që vlefshmëria dhe plotësimi i tyre të përcaktojnë rëndësinë e tyre dhe të eliminojnë çdo paqartësi të mundshme kontradiktore. Një gjurmë individuale mund të sigurojë informacione për një pjesë të ngjarjes, ose të tregojë drejtimin në të cilin drejtohet aktiviteti operativ në kërkimin e të dyshuarve, dhe është e nevojshme, përveç

individit, të vëzhgojë dhe analizojë çdo gjurmë brenda të gjitha fakteve treguese në dispozicion dhe mundësisht provave të dhëna tashmë.

Kjo vetëm konfirmon qasjen e duhur për përdorimin e provave të kombinuara, të cilat duhet të përdoren në të gjitha situatat kriminale-taktike kur është e mundur. Tashmë në vendin e ngjarjes fillon përdorimi operativ i gjurmëve materiale, me bashkëpunimin dhe veprimin e sinkronizuar të hetuesit operativ dhe teknikut të forenzik. Nëse gjurmët në vendin e ekzekutimit japin informacion të dobishëm, ato duhet të vlerësohen menjëherë dhe të fillojë përdorimi i tyre operativ, pa prituri që puna e përfunduar e hetimit të përfundojë. Rëndësia operative e të dhënave është veçanërisht e theksuar kur intervistoni të dyshuarit, kështu që informacionet që ata ofrojnë duhet të përdoren në këtë kuptim, dhe jo pa asnjë bazë për të insistuar në rrëfimin e kriminit. Siç kemi thënë tashmë, çdo gjurmë individuale e një krimi ka mekanizmat e veta të ndodhjes, dhe për shkak të vetë larmisë së origjinës dhe ekzistencës së saj, është e nevojshme dhe trajtim i ndryshëm i gjurmëve të tilla, d.m.th., për secilën gjurmë materiale të kriminit. Ekzistojnë gjithashtu metoda dhe mjete speciale për zbulimin, skicimin dhe fiksimin e tyre, të cilat janë pjesërisht specifike vetëm për atë gjurmë, natyrisht, pa eliminuar mundësinë e përdorimit të të njëjtave metodave në gjurmë të tjera.

2.1.2 Fiksimi i gjurmëve nga mjetet e përdorura.

Qëllimi përfundimtar i përdorimit operativ të gjurmëve materiale është të përgjigjemi sa më shpejt që të jetë e mundur pyetja e parë të artë të kriminalistikës – ” çfarë ndodhi ”, d.m.th. të bëhet një diagnozë diferenciale kriminalistike e ngjarjes, duke vendosur kështu nevojën dhe bazën për trajtim të mëtejshëm operativ. Së pari, është e nevojshme të sqarohet nëse bëhet fjalë për një incident apo një ngjarje kriminale, kështu që nëse identifikohet një ngjarje kriminale, duhet të sqarohet se çfarë krimi specifik është i përfshirë, i cili në shumë situata kriminale-taktike nuk do të jetë e mundur të bëhet pa këqyrjen e dëshmitarëve të caktuar ekspertë. Gjurmët materiale të gjetura gjatë hetimit mund të japin përgjigje për pyetje të tjera të arta të kriminalistit, i cili përsëri varet nga një numër i fakteve që lidhen me krimin dhe

autorin e krimit, dhe sigurisht që jo gjithmonë do të jetë i mundur, por është e rëndësishme të njihni vlerën dhe shtrirjen e secilës gjurmë materiale.

Kështu që ata mund të tregojnë një motiv për kryerjen e një krimi, si psh gjurmët e spermës, shenjat e kafshimit, shenjat e gjymtimit, etj., që ka një rëndësi të madhe operative, sepse ato drejtojnë punën operative në përpunimin kriminalistik, drejt të dyshuarve. Për më tepër, në shumë situata, të dhëna mund të ndihmojnë gjithashtu në përcaktimin e vendit dhe kohës së krimit, si dhe të tregojnë nëse një ose më shumë persona morën pjesë në kryerjen e tij. Ekzistojnë veçanërisht gjurmë biologjike karakteristike, gjurmë të tokës, gjetheve, ngjyrave, etj. Të dhëna të gjetura në vendin e ngjarjes mund të shërbejnë gjithashtu për të vendosur identitetin e personave të pranishëm në vendngjarje dhe, për rrjedhojë, për të treguar në rrethin e të dyshuarve drejtimin në të cilin janë vendosur versionet e duhura. Këto janë, mbi të gjitha, gjurmë të vijave papilare, gjurmë të pështymës, gjakut, spermës dhe të ngjashme. Më në fund, të dhënat mund të shërbejnë gjithashtu për të identifikuar palën e dëmtuar, si psh. gjurmët e linjave papilare, gjurmët e numrave të fshirë në motor dhe shasin e një makine etj.

3. Personaliteti i kryerësit.

Për sa i përket **moshës** mesatare të personave të përfshirë në këtë krim, rezulton të jetë rreth 20-30 vjeç, në periudhën e kryerjes së veprave penale, ose edhe më të rinj. Për sa i përket llojit të veprimtarisë kriminale, vihet re mosha relativisht më e madhe e personave të përfshirë në trafikun e armëve dhe municioneve, që llogaritet të jetë rreth 40-50 vjeç. Moshat më të reja janë të pranishme në nivelet bazë të trafikut të narkotikëve (transportues dhe shpërndarës), si dhe rekrutuesit e viktimave të trafikimit.

Lidhur me nivelin arsimor të personave të përfshirë në krim të organizuar, rezulton se pjesa më e madhe e tyre ndahet midis arsimit të detyrueshëm 8-vjeçar dhe atij të mesëm. Gjithashtu, shumica e të intervistuarve raportojnë se vitet e fundit është rritur ndjeshëm numri i personave me arsim të lartë të përfshirë në krim të organizuar.

Lidhur me gjendjen shoqërore e familjare, autorët e këtyre veprave janë shumica prej tyre të pamartuar dhe vijnë shumë herë nga familje problematike prej vitesh, të tilla si me prindër të divorcuar, me problematika alkoli, dhune apo fatkeqësie të ndryshme.

Lidhur me **gjendjen ekonomike**, autorët e veprave të vjedhjeve shfaqin problematika të shumta me varfërinë, vijnë nga familje të varfëra dhe janë të papunë kryesisht.

4.Viktima.

Viktima e veprës penale të vjedhjes ka të drejtë:

- a. të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit;
- b. të përfitojë kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale;
- c. të komunikojë në gjuhën e saj dhe të ndihmohet nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar;
- d. të zgjedhë mbrojtës dhe, kur është rasti, të përfitojë ndihmë juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi;
- e. të kërkojë, në çdo kohë, informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat, pa cenuar parimin e sekretit hetimor;
- f. të kërkojë marrjen e provave, si dhe të parashtrojë kërkesa të tjera përpara organit procedues;
- g. të informohet për arrestimin e të akuzuarit dhe lirimin e tij, në kushtet e caktuara në këtë Kod;
- h. të njoftohet për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjykimit;
- i. të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen;

- j.** të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal;
- k.** të përjashtohet, në kushte të caktuara me ligj, nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe tarife gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-padisë që lidhen me statusin e viktimës së veprës penale;
- l.** të thirret në seancën paraprake dhe në seancën e parë gjyqësore;
- m.** të dëgjohet nga gjykata, edhe kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen e saj si dëshmitar;

Viktima që nuk ka zotësi për të vepruar, i ushtron të drejtat e saj nëpërmjet përfaqësuesit të saj ligjor ose kujdestarit të tij, përveçse kur kjo nuk është në interesin e viktimës. Kur vëren papajtueshmëri mes interesave të viktimës dhe atyre të përfaqësuesit ligjor ose kujdestarit, gjykata cakton një kujdestar të posaçëm⁵⁷.

Duke pasur parasysh sa është thënë më lartë lidhur me tendencat bashkëkohore për ridefinimin e pozitës së viktimës në të drejtën penale, lehtë mund të konstatohet se ligjet e Maqedonisë që kanë të bëjnë me çështjet penale janë plotësisht të orientuara drejt kryerësit të veprës penale. Në qoftë se analizohet Kodi Penal i RMsë në këtë aspekt, gjëja e parë që do të konstatohet është se termi “viktimë” nuk paraqitet fare në pjesën e përgjithshme të këtij kodi (ashtu si edhe në shumë vende tjera me sistem juridik kontinental, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë – në vazhdim KPRM – përmban dy pjesë, pjesën e përgjithshme që ka të bëjë me konceptet e përgjithshme të krimit, përgjegjësisë penale dhe sanksioneve penale dhe pjesën e posaçme që ka të bëjë me veprat konkrete penale); që do të thotë se viktima nuk paraqet një subjekt të veçantë dhe të pavarur të të drejtës penale.

E gjithë pjesa e përgjithshme e KPRM ka të bëjë kryesisht me kryerësin dhe të drejtat e tij. Kështu, po të merret në konsideratë neni 31 i KPRM do të kuptohet që qëllimet e vetme të sanksioneve penale janë retribucioni, parandalimi specifik dhe i përgjithshëm dhe rehabilitimi i kryerësit. Restituimi dhe kompensimi i viktimës nuk përmenden fare si qëllime të sanksionit penal. Është e qartë që segmenti restorativ i drejtësisë penale në Maqedoni akoma dukshëm mungon edhe ligjërisht. I vetmi termin që është i përafërt me kategorinë e viktimave

⁵⁷ Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë.

identifikohet në nenin 99 të KPRM që flet mbi të drejtën e personit të dëmtuar të kërkojë restituimin e pronës së tij.

Si është përmendur më lartë, restituimi i pronës së dëmtuar është vetëm njëri nga elementet konstitutive të të drejtave të viktimës në teorinë bashkëkohore të cilat kërkojnë një angazhim më evident dhe të dukshëm të viktimës duke përfshirë këtu participimin por edhe mbrojtjen e tij. Sa i përket terminologjisë, për mendimin tim termi “person i dëmtuar” që përdoret si në KPRM ashtu edhe në Ligjin për Procedurë Penale të Republikës së Maqedonisë (në vazhdim LPPRM), është shumë më i ngushtë se termi “viktimë” pasi që ai termin kufizohet vetëm tek personat që kanë vuajtur dëm material dhe është kryesisht i drejtuar në kompensimin material apo lukrativ të dëmit.

Termi “person i dëmtuar” paraqitet më shpesh në LPPRM duke u dhënë mundësinë këtyre personave të dalin në skenën e drejtësisë si që do isha shprehur në mënyrë ironike, kur asgjë tjetër nuk ka sukses. Pra, “personi i dëmtuar” ose “paditësi privat” janë palë subsidiare e jo primare në një proces penal. Është e qartë që roli i prokurorit është shumë i rëndësishëm dhe esencial, sidoqoftë, në mënyrë që realizimi i standardeve të drejtësisë të bëhet i mundur, edhe të drejtat e viktimës dhe trajtimi i drejtë i saj duhet të kuptohet si thelbësor.

Që të arrihet kjo, së pari viktimat duhet të pranohet si palë direkte në proces dhe të realizohen të drejtat themelore të saj: participimi, mbrojtja dhe restituimi. Kjo do të duhej të ishte fryma e reformave në legjislacionin penal të Maqedonisë që janë duke u zhvilluar tani. Ka pasur përpjekje administrative të theksimit të rolit dhe brishtësisë së viktimave të disa krimeve të veçanta si Trafikimi me qenie njerëzore ose Dhuna në familje (kryesisht programe të qeverisë dhe OJQve të ndryshme për mbrojtje dhe strehim të viktimave), sidoqoftë, kjo qasje e kufizuar ndaj një çështjeje kaq të rëndësishme duhet ngritur në një nivel më të lartë me anë të ridefinimit të dispozitave ligjore në një mënyrë që do të ishte e drejtë për “të dy anët e tregimit”.

KAPITULLI I KATËRT

PROCESUIMI KRIMINALISTIK PAS ZBULIMIT TË VEPRAVE PENALE – GRABITJET DHE VJEDHJET E RËNDA, ME SHQYRTIM (AKCENT-TRAJTIM) TË VEÇANTË – TË POSAÇEM TË KËTYRE VEPRAVE TË KRYERA NË PJESËN PERËNDIMORE TË RMV 2013-2019 DHE PARANDALIMI I TYRE

1. Mënyra e zbulimit të ekzistimit të veprës penale – grabitje dhe vjedhje të rëndë.

Sipas nenit 106 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, Prokuroria Publike parashikohet si organ i vetëm dhe i pavarur shtetëror që ndjek autorët e veprave penale dhe të veprave të tjera të dënueshme nga ligji. Prokuroria Publike kryen funksionet e saj në bazë dhe në kuadër të Kushtetutës dhe ligjit.

Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut një herë në vit dorëzon raport në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për zbatimin e masave të posaçme hetimore që janë ndërmarrë në vitin paraprak kalendarik. Qëllimi i paraqitjes së raportit është informimi i Kuvendit për të dhëna që paraqesin në mënyrë statistikore dinamikën e zbatimit të këtyre masave, si dhe njohjen e qytetarëve me shkallën e zhvillimit të kriminalitetit në vend. Në këtë raport, jepen të dhëna për numrin e procedurave hetimore të ndjekura dhe për cilat vepra penale janë zbatuar këto masa, numri i objekteve dhe personave të vëzhguar, kohëzgjatja e secilës masë në veçanti, etj.

Raportet e deritanishme vjetore për zbatimin e masave të posaçme hetimore përmbajnë vetëm të dhëna statistikore për numrin dhe llojin e zbatimit të masave të posaçme hetimore, veprat penale ndaj të cilave janë zbatuar masat, etj. Nga ana tjetër, nga raportet është evidente se zbatim më të madh ka masa e posaçme hetimore.

2. Parandalimi tek veprat penale – grabitje dhe vjedhje e rëndë.

Globalizimi dhe shtrirja ndërkombëtare e veprimtarive kriminale ka krijuar një nevojë të madhe për forma të forcuara të bashkëpunimit ndërkombëtar ndërmjet strukturave të posaçme të hetimit, me qëllim parandalimin në maksimum të krimit të organizuar dhe veprimtarive të tyre kriminale. Hetimi, ndjekja penale dhe kontrolli i këtyre veprimtarive nuk mund të kufizohen brenda kufijve nacionalë, por shtrihen edhe më tej. Për trajtimin e formave bashkëkohore të krimit, përfshirë krimin e organizuar transnacional, korrupsionin dhe terrorizmin, duhen mekanizma të përmirësuar për bashkëpunim mes vendeve.

Në luftën kundër krimit të organizuar për Republikën e Maqedonisë së Veriut është gjithashtu e rëndësishme që të zhvillohet më tej bashkëpunimi me vendet fqinje të rajonit, apo edhe më

gjerë, ato të të BE-së dhe në situata të caktuara të thjeshtohen kushtet për bashkëpunim në fushën e ndihmës juridike ndërkombëtare në çështjet penale. Për të përcaktuar më tej kushtet për bashkëpunim, Republika e Maqedonisë ka lidhur një numër marrëveshjesh dypalëshe dhe shumëpalëshe me vendet fqinje, dhe legjislacioni i saj është pothuajse plotësisht i harmonizuar me *acquis communautaire* e BE-së në këtë pjesë. Sidoqoftë, duhet ende të arrihet harmonizimi i plotë me rregulloret e zbatueshme të BE-së, çka varet nga procesi i lidhur me anëtarësimin në BE.

Nga aspekti i bashkëpunimit ndërkombëtar, sistemi maqedonas është në transformim të vazhdueshëm për të adresuar nevojat dhe sfidat bashkëkohore që lidhen me krimin e organizuar transnacional dhe bashkëpunimin e ndërsjellë me vendet e tjera. Nga informacionet e paraqitura në këtë raport, mund të konkludohet se Maqedonia po ndjek trendet në këtë çështje dhe po merr pjesë aktive në forma të ndryshme, në mënyrë që të përmirësojë dhe thjeshtojë kanalet e bashkëpunimit me vendet fqinje dhe vendet e treta.

Me reformën e legjislacionit penal, dhe me gatishmërinë e saj për të pranuar metoda të reja të bashkëpunimit me vendet e tjera dhe për thellimin e bashkëpunimit me vendet e Ballkanit Perëndimor, si dhe me vendet e BE-së, Republika e Maqedonisë ka treguar kapacitete dhe iniciativa të mjaftueshme për të luftuar krimin e organizuar transnacional që nuk ka kufij. Sidoqoftë, ekziston nevoja për përmirësim të vazhdueshëm dhe rritje të standardeve të bashkëpunimit gjyqësor në të gjitha nivelet, veçanërisht me vendet e Ballkanit Perëndimor, përmes programeve për ndërtimin e kapaciteteve, takimeve të rregullta mes autoriteteve gjyqësore, dhe praktikave të shkëmbimit të informacionit.

Nëse ndalemi tek masat që duhet të marrë ky shtet me qëllim parandalimin e kryerjes së mëtejshme të veprave penale që lidhen me vjedhjet, duhet të shohim fillimisht masat e përgjithshme të ndërmarra në nivel ndërkombëtar, pastaj të kalojmë tek masat e marra në nivel specifik brenda vetë shtetit. Këtu mund të rendisim:

- Të përmirësohet më tej bashkëpunimi gjyqësor në çështjet penale, duke ratifikuar marrëveshjet ndërkombëtare dhe dypalëshe;

- Të përdoren udhëzimet e njëjta në të gjitha gjykatat për të siguruar qasje dhe praktika të unifikuara;
- Të zhvillohet dhe menaxhohet me efikasitet sistemi i gjykatave për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave statistikore për lëndët e gjykatave;
- Të përmirësohet dhe promovohet komunikimi i drejtpërdrejtë mes autoriteteve gjyqësore me homologët e tyre në vendet e tjera;
- Të rritet bashkëpunimi policor ndërmjet vendeve fqinje me Maqedoninë e Veriut;

Me qëllim të forcimit dhe thellimit të bashkëpunimit dhe luftës kundër krimit transnacional, institucionet nga Republika e Maqedonisë janë anëtare të organizatave të dallueshme evropiane⁵⁸ dhe ndërkombëtare. Përveç kësaj, ndër të tjera, vendi është anëtar i INTERPOL-it, ILECU, SELEC/SEEPAG dhe rrjeteve dhe organeve të tjera rajonale si Rrjeti i Prokurorëve të Ballkanit Perëndimor.

Që nga viti 2003, Republika e Maqedonisë është gjithashtu anëtare e SEEPAG, i krijuar për të lehtësuar bashkëpunimin gjyqësor në hetime dhe lëndë të rëndësishme të krimit transkufitar. Si një rrjet i prokurorëve me përvojë, SEEPAG ka për detyrë të ndihmojë SELEC në çështje operative dhe të lehtësojë shkëmbimin e shpejtë të informacionit dhe provave në hetimet transkufitare, si dhe të sigurojë udhëzime, ndihmë dhe rekomandime për politikëbërësit në rajon për çështjet e drejtësisë dhe zbatimit të ligjit.

Republika e Maqedonisë është vendi i parë nga Ballkani Perëndimor që ka nënshkruar marrëveshje operationale dhe strategjike me EUROJUST në vitin 2008, me qëllim të shkëmbimit të informacionit, lehtësimit dhe koordinimit të hetimeve dhe pjesëmarrjes në takimet strategjike dhe operationale.

Në bazë të marrëveshjes së nënshkruar me EUROJUST, Maqedonia ka emëruar persona kontakti nga Ministria e Drejtësisë, nga Prokuroria Themelore Publike për krimin e organizuar, nga Gjykata Themelore dhe nga Prokuroria Publike Speciale.

⁵⁸ Republika e Maqedonisë është anëtare aktive në organet e Këshillit të Evropës, të tilla si GRECO, GRETA, CODEXTER, CCPE, PC-OC, etj

Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC) është një tjetër rrjet i krijuar në vitin 2008 me qëllim të intensifikimit të bashkëpunimit në rajonin e Evropës Juglindore në fushat me interes të përbashkët, si dhe për të përmirësuar lidhshmërinë, për të rritur lëvizshmërinë, për të përmirësuar sundimin e ligjit dhe për të forcuar sigurinë në rajon. Në lidhje me ndihmën juridike ndërkombëtare, në strategjinë e vet RCC është i përkushtuar të mbështesë mekanizmat ekzistues dhe platformat tashmë të vendosura në rajonin e Ballkanit (SELEC, SEEPAG, SEPCA, dhe PCC SEE) dhe të adresojë sfidat e reja të sigurisë në rajon.

Republika e Maqedonisë është gjithashtu anëtare e Rrjetit të Prokurorëve të Ballkanit Perëndimor (ĒBPN) që nga viti 2006. ĒBPN është një iniciativë e mbështetur nga GIZ dhe Qendra për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (CILC) përmes Programit Rajonal IPA për luftimin dhe kundërveprimin ndaj krimit të organizuar të rëndë dhe korrupsionit në Ballkanin Perëndimor⁵⁹. Aktivitetet e ndërmrra janë përqendruar në forcimin e strukturës operacionale të zbatimit të ligjit dhe agjencive gjyqësore për bashkëpunim ndërkufitar, hetim, shkëmbim informacioni dhe të dhëna, bashkëpunim përmes shfrytëzimit të nismave rajonale, përgatitjen e parakushtit për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit, si dhe në ndërtimin e aftësive dhe kapaciteteve të agjencive të zbatimit të ligjit, duke rritur kështu efikasitetin e tyre.

Ndër kushtet e veçanta, apo specifike që duhen marrë nga ana e shtetit maqedonsa me qëllimin parandalimin e kryerjes së vjedhjeve të rënda, ne mund të veçojmë:

Arsimi

Arsimi përbën një faktor me rëndësi në formimin dhe aftësimin e personalitetit të individit për një jetë më të sigurt dhe më të suksesshme⁶⁰. Praktikrat kudo në botë mendojnë se arsimimi është një mjet i fortë për pengimin e sjelleve devijante dhe kriminale. Personat

⁵⁹ Vende të tilla si: Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia dhe Kosova.

⁶⁰ Prof.Dr. Halili, Ragip, Kriminologjia, Prishtinë, 2011.

me arsim të lartë, janë të prirur të kenë qëndrime dhe sjellje pozitive⁶¹ dhe më pak të prirur drejt sjelljeve devijante kriminale, të tilla si vrasjet apo vjedhjet.

Sipas shumë autorëve dhe kriminologëve, ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet sjelleve kriminale të individëve dhe shkallës së tyre të arsimit, ku personat e paarsimuar të cilët kryejnë krime, janë të zhveshur nga ndërgjegjja dhe etika duke i'u nënshtruar më lehtë impulseve emocionale.

Nga të dhënat e ndryshme statistikore, dëshmohet se pjesëmarrja e personave të paarsimuar ose me shkallë të ulët të arsimit është më e madhe në kryrejen e sjelleve penale në shumë vende. Në Maqedoninë e Veriut numri më i madh i veprave penale të vjedhjes kryhet nga personat me arsim më të ulët, ose edhe analfabet, por nuk duhet mohuar se kohët e fundit dominojnë edhe personat me arsim të lartë, të cilët i kryejnë ato.

Roli i mediave të shkruara dhe elektronike

Në luftën kundër kriminalitetit, rol të rëndësishëm luan edheinformimi i drejtë i qytetarëve në lidhje me sjelljet kriminale në një mjedis të caktuar⁶². Arritja e informimit të qytetarëve në lidhje me këto bëhet në mënyra të ndryshme me mjetet e informimit publik si (radio, televizion, filmi, shtypi, etj). Roli i tyre është i madh pasi që ato paraqesin një roltë rëndësishëm edukativ. Me qëllim të nxitjes së efekteve pozitive të qytetarëve shtypi nukduhet të bjerë nën ndikimin e efekteve sensacionale por duhet të jep informata të sakta dhe objektive qoftë në lidhje me kriminalitetin si dukuri por edhe në rastet e posaçme të aktivitetitkriminale⁶³.

Mendohet se një pjesë e madhe e autorëve të rinj të veprave të tilla penale, është rezultat i drejtpërdrejtë i ndikimit të disa mjeteve të komunikimit masiv. Mjetet e informimit ndikojnë në formimin e drejtë të personalitetit të njeriut, i cili ndikohet gjatë transmetimit të përmbajtjeve të ndryshme që shfaqen në televizion. Këto mjete ndikojnë edhe pozitivisht në

⁶¹ Vesel Latifi, "Politika Kriminale", Prishtinë, 2003;

⁶² 3Vesel Latifi, "Politika Kriminale", Prishtinë, 2003;

⁶³ Prof.Dr. Halili, Ragip, Kriminologjia, Prishtinë, 2011.

pengimin e kryerjeve të veprave penale, nga ana e autorëve, për shkak të masës së ndëshkimit që i'u jepet atyre, por gjithashtu ato ofrojnë edhe nxitje te autorët për kryrje të veprave penale kriminale nga shpeshia e shfaqjes së tyre në TV. Gjithashtu edhe mjetet teknologjike që flasin për temat sociale, politike, shoqërore, po luajnë një rol shumë të rëndësishëm dhe me efekte pozitive, por në të shumtën e rasteve edhe negative.⁶⁴

Në përmbajtjet e shkrimeve, revistave dhe rrjeteve sociale të ndryshme, si motiv dhe qëllim kryesor dominon intersi komercial, fitimi dhe pasurimi. Në shumë shkrime dhe gazeta, apo dokumentarë shfaqen shumë herë shenja dhune, jeta e pasur, pronografia, prostitucioni. Këto përmbajtje ndikojnë shumë tek të rinjtë⁶⁵.

Organizata joqeveritare

Në ditët sotme funksionojnë një sërë organizatash ndërkombëtare joqeveritare, në nivelin rajonal apo global dhe në fusha të ndryshme si bamirësia, mjedisi, të drejtat e njeriut, sporti, etj⁶⁶. Veçori e tyre është se në përgjithësi janë jofitimprurëse, pra organizime që nuk udhëhiqen nga grumbullimi i fitimeve, por nga avancimi i idealeve të tyre në botë. Si të tilla ato tërheqin interesimin e shumë njerëzve idealistë nëpër botë, japin ndihmesën e tyre vullnetare në forma të ndryshme, si aktivistë, dhurues, sensibilizues etj.

Me organizata joqeveritare nenkuptojmë organizatë jo-qeveritare e regjistruar në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Ajo mundet të jetë “shoqatë” apo “fondacion” i themeluar për të ndjekur çështjet e përfitimit shoqëror ose interesit të dyanshëm dhe vepronjë në gjithë territorin e Republikës maqedonase.

Roli i familjes

⁶⁴ Prof. Dr. Josifoski D, Kriminalistika Psikologjike , Shkup, 1995

⁶⁵ Prof. Dr. Josifoski D, Kriminalistika Psikologjike , Shkup, 1995

⁶⁶ Prof.Dr. Vesel Latifi, Politika Kriminale, Prishtine, 2008

Një rol të padiskutueshmë në parandalim të kriminalitetit, luan familja, e cila është grup themelor i shoqërisë dhe që mbledh rreth vetes njerëz të lidhur me martesë, dhe pasardhësit e tyre në lidhje gjaku, apo lidhje të tjera, me qëllim që të plotësojnë nevojat e ndryshme biologjike, ekonomike, sociale, edukative, motive etj.⁶⁷ Familja si bashkësi paraqet faktorin më me rëndësi në zhvillimin dhe formimin e personalitetit të njeriut.

Duke parë zhvillimet e reja dhe dinamizmin e jetës, familja është duke u transformuar dhe duke krijuar dobësi në lidhjet familjare⁶⁸. Këta ndryshime të reja që kanë bërë që familja të jetë e paaftë të kryej me sukses rolin edukativ. Në kuadër të këtyre masave me rëndësi është ti kushtohet vëmendje e posaçme aftësimittë familjes dhe realizimit të suksesshëm të funksionit edukues dhe për ti vërejtur me kohësimitomat e papërshtatshmërisë të fëmijët dhe për të marr masa me qëllim të korigjimit të tyre dhe orientimit të tyre më shpejt drejt rrugës së drejt të zhvillimit⁶⁹. Përveç familjes e cila mund tëndikojë në sjelljet kriminale të miturve, ndikojnë edhe faktorë të tjerë si kushtet ekonomike, kulturore, papunësia, varfëria, kushte këto të gjitha që çojnë drejtrritjes së numrit të vjedhjeve në vend. Kjo sepse familja si faktor kriminogjen nuk mund të shihet ndaras nga ndikimi i faktorëve të tjerë të shoqërisë⁷⁰.

Roli parandalues i familjes mund të jetë më i suksesshëm nëse familja ka mirëqënie dhe kushte të favorshme ekonomike. Vihet re se numri i familjeve të divorcuara, me shumë anëtar, me prindër të papunësuar, nuk mund të japin rezultate të suksesshme në këtë lloj parandalimi, prandaj është e domosdoshme që faktori shoqëror përmes politikave kriminale të ndërmarra masa të ndryshme parandaluese⁷¹.

3. Masat preventive që i ndërmer Ministria e Punëve të brendshme në RMV

⁶⁷ Gazeta zyrtare e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë / Prishtinë :viti i / nr. 4 / 01 shtator 2006 ,ligji nr. 2004/32, Ligji për Familjen i Kosovë

⁶⁸ Prof,Dr. Ragip Halili, Kriminaliteti kunder martesës dhe familjes në Kosovës, Prishtinë, viti 1987, fq.17-20

⁶⁹ Prof, Dr. Halili, Ragip, Kriminologjia, Prishtinë, 2011;

⁷⁰ Prof,Dr.Vesel Latifi, " Politika Kriminale" , Prishtinë,2005;

⁷¹ Prof, Dr. Arsim Bajrami, Sistemi Kushtetues I Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2011

Ministria e Punëve të Brendshme është institucioni kryesor qendror në Republikën e Maqedonisë, i cili bën të mundur hartimin e politikave dhe zbatimin e tyre, duke ushtruar një funksion kontrollues në nivel qendror mbi zbatimin e masave dhe kushteve konkrete, përsa i përket shkallës së kriminalitetit në vend. Ndër objektivat kryesore të saj dhe funksionet që ajo kryen, mund të përmendim:

- realizimin e sistemit të sigurisë shtetërore dhe publike;
- paraqitje të vendbanimit dhe vendqëndrimit;
- shtetësia dhe dokumentet e udhëtimit për kalimin e kufirit shtetëror;
- lëvizje dhe qëndrim në rripin kufitar;
- kontrollin e kalimit të kufijve shtetërore, si dhe punë të caktuara lidhur me verifikimin dhe zgjidhjen e identiteteve kufitare dhe shkelje të tjera kufitare;
- qëndrimi dhe lëvizja e të huajve;
- prodhimtaria, prometi, deponimi dhe mbrojtja nga tretjet djegëse, gazrat, eksplozivët dhe materie të tjera të rrezikshme dhe transporti i këtyre materiale;
- ofrimin e ndihmës gjatë fatkeqësive elementare dhe epidemive;
- furnizimi, posedimi, mbajtja dhe kontrolli i shënimit të armëve dhe municionit;
- mbikëqyrjen nga kompetencat e saj; dhe,
- kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj⁷².

Ministria e Brendshme i kryen të gjitha veprimtaritë e saj, duke ushtruar kontroll, apo kordinim me policinë e vendit, e cila kujdeset për mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti, mbajtjen e rendit dhe të qetesise publike, si dhe sigurimin e rendit të caktuar shtetëror⁷³. Policia është një institucion tradicional i njohur për mbrojtjen e rendit shoqëror në të gjitha shtetet e ndryshme të botës.

Policia përbën një hallkë shumë të rëndësishme në të gjithë zinxhirin e sistemit gjyqësor, pasi është hallka e parë e këtij zinxhiri, e cila pasi kap autorët, regjistron veprat penale, vlerëson rëndësinë e tyre, ndjek gjendjen e kriminalitetit në vend dhe metodat e veprimit të autorëve

⁷²<https://vlada.mk/node/14988?ln=sq>

⁷³ Prof. Dr. Vesel Latifia, Politika Kriminale, botimi 2008, Prishtine

gjatë ekzekutimit të veprave penale, merr dhe fikson gjurmët në territorin e kryerjes së veprave penale, si dhe kohën e kryerjes së tyre, si dhe merr masa të vazhdueshme parandaluese.⁷⁴

Përmes vlerësimeve të gjendjes reale faktike të kryerjes së vjedhjeve të ndryshme, policia jep vlerësimet e gjendjes së sigurisë në territoret e caktuara dhe jep informacion për autorët, apo grupet e ndryshme kriminale, dhe për këtë informon qytetarët me anë të mjeteve të komunikimit masiv, në lidhje me aspektin politik dhe kriminal⁷⁵.

Policia ofron ndihmë të vlefshme gjykatave dhe prokurorisë, mbi zbatimin e të drejtës penale dhe të veprimtarisë represive duke kryer edhe shërbime sociale.

Aktiviteti i policisë po transformohet gjithnjë e më shumë në kuptimin parandalues në kushtet kur kriminaliteti i vjedhjeve ka marrë shtrirje më të gjerë⁷⁶. Ndër masat e saj parandaluese mund të përmendim:

- mbikqyrja dhe patrullimi i shpeshtë i terrenit gjatë ditës dhe gjatë natës po ashtu;
- kryerja e shërbimit të mbikqyrjes së përgjithshme në vend;
- kryerja e kontrollit në rrugë;
- dhënie e këshillave qytetarëve me qëllim të mbrojtjes nga vepra penale;
- informimi i vazhdueshëm i qytetarëve me qëllim të mbrojtjes nga veprat penale;

Gjithashtu policia ushtron krijimin e grupeve të posaçme operative me qëllim të identifikojë grupet kriminale dhe të marr masa për kapjen e tyre, ku ka rol për parandalimin e organizimit në luftimin dhe trajtimin e të gjitha llojeve të veprave penale⁷⁷.

Për parandalimin e suksesshëm të veprave të vjedhjeve dhe për luftimin e kriminalitetit, bashkëpunimi policor duhet të shtrihet edhe në rrafshin ndërkombëtar nëpërmjet:

Në kuadër të veprimtarisë së policë dallohet edhe aktiviteti i policisë gjyqësore, të cilat janë të autorizuar të ndihmojnë prokurorin dhe gjykatat dhe të hetojnë veprat penale të kallëzuara. Si

⁷⁴ Komentari I Kodit Penale-pjesa e posaçme e Republikës së Kosovës, Prof, Ismet Salihu, Prof, Hilmi Zhitija, Prof. Hasan Fejzullahu, botimi 2014, Prishtinë

⁷⁵ Prof, Dr. Arsim Bajrami, Sistemi Kushtetues I Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2011

⁷⁶ E drejta penale pjesa e posaçme, Prof, Ismet Salihu, Prishtinë, 2014

⁷⁷ Latif, Veseli, Kriminalistika, Prishtinë, 2011.

rrezik ndajpunës së policisë është korrupsioni i cili lajmërohet sidomos në ato vende ku kriminaliteti është organizuar. Andaj autorizimet dhe kompetencat e policisë janë të rregulluara hollësisht dhe ligjërisht. Politika kriminale duhet të planifikojë dhe programoj masa pëever aftësimin dhe përsosjen e policisë për parandalimin dhe luftimin me sukses të kriminalitetit. Sipas vlerësimeve të INTERPOLIT në shumë ish vende socialiste janë formuar shtete në shtete nga ana e kriminalitetit të organizuar, veprimtaria e të cilave përfshin prostitucionin, larjen e parave, tregtia ilegale me drogë dhe me armë, vrasjet sipas porosisë etj dhe në fund edhe lufta në mëstë grupeve kriminale për zotërimin e territorit

është i rregulluar me detajisht me ligjin përkatës për policinë, në bazë të cilit edhe është themeluar ky institucion.

Profesionalizimi i policisë shtrihet edhe në zbatimin e parimeve dhe standarteve të pranuar gjerësisht nga shumë legjislatore, të tilla si:

- Parimi i trajtimit të drejtë dhe të barabartë të të gjithë personave;
- Parimi i respektimit të drejtave dhe lirive themelore;
- Parimi i legjitimitetit, paanshmërisë dhe proporcionalitetit;
- Parimi i mosdiskriminimit, në bazë etnike, gjinore;
- Parimi i transparencës dhe ofrimi i informatave për qytetarët.

Ndër detyrat e tjera të policisë në kuadër të parandalimit mund të përmendim:

- Ta mbroje jetën, sigurinë dhe pronën e të gjithë personave;
- T'i mbroje të drejtat dhe liritë themelore të gjithë personave;
- Ta parandaloje rrezikun ndaj qytetarëve dhe ta mbaje rendin dhe sigurinë publike;
- T'i hetojë veprat penale;
- Të ofrojë mbrojtje dhe kontroll të kufijëve etj.

Autorizimet e policisë janë kryerja e kontrollit të arsyeshëm mbi njerzit dhe pronën e tyre sa i lejohet, të japë dhe të zbatojë urdhrat dhe instruksione për antaret e shoqërisë, autorizimi për patrullimin dhe kontrollin e kufirit me qëllim të gjatit për të eliminuar faktorët negativë që zhvillohen në kufi, autorizimi për marrjen e masave të nevojshme për të mbrojtur personat që i nënshtrohen çfarëdo lloji të diskriminimit etj. Në Kosovë organizimi i policisë shtrihet në nivel qendror dhe

ne nivel lokal, organizmi i policise behet ne kete menyre : Drejtoria Qendrore, DrejtoriteRajonale, Stacionet Lokale, Stacionet Kufitare.

4. Masat preventive të ndërmarra nga ana e qytetarëve.

Kuptimi i kriminalitetit bashkëkohor i të miturve si sjelljet, veprimet antishoqërore dhe anti ligjore si kryerës të veprave penale, dhe përcaktimi i moshës së tyre që është prej 14-18 vjeç. Sjelljet devijuese (sjelljet agresive, dëshira për shkatrim të të mirave materiale, vjedhje mos qëndrimi në shkollë), veprat e rënda kriminale (vrasja, dhunimi, sulmi seksual kundër fëmijve, mundësimi i përdorimit të drogës, vjedhjet, vjedhjet e rënda etj.) dhe pjesëmarrja në krimin e organizuar (trafikimi i armëve, drogës, prostitucionit,) përmbledhin format e shfaqjes së kriminalitetit bashkëkohor të të miturve.

Veprat penale të cilat më së shumti na paraqiten nga hulumtimi i kryer janë kundër pasurisë të cilat janë mbi 50 %. Të dhënat statistikore japin një numër në rritje gjatë viteve të fundit. Tranzicioni i gjatënë Republikën e Maqedonisë dhe vështirësitë financiare me të cilat ata përballen përditë, duke mos patur mundësi që ti plotësojnë nevojat e tyre financiare dhe materiale nga ana e prindit, kthehet në përfshirje të aktiviteteve kriminale.

Për pjesën më të madhe të veprave penale që kryhen nga të miturit ndikojnë familja, shkolla, masmedias, etj. Shkolla si institucion për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve duhet të organizojë më shpesh aktivitete kulturore, apo trajnime të ndryshme ku t'ju shpjegohet të miturve për pasojat pas kryerjes së veprave penale, si vjedhje, apo vrasje. Mas mediat poashtu duhet ti kushtojnë rëndësi këtij fenomeni duke transmetuar dokumentare të ndryshme lidhur me të mitur si autorë të veprave penale dhe poashtu të shfaqë pasojat që vijnë për këta të mitur.

Në realitet nuk mund të themi se në drejtim të parandalimit të kriminalitetit bashkëkohor nuk është duke u punuar nga këto struktura, por konstatojmë se duhet ende të merren masa më të favorshme parandaluese që kriminaliteti bashkëkohor i të miturve në Republikën e Maqedonisë të zvoglohet.

Për fat të keq, tek të rinjtë në Maqedoni akoma ekziston dëshira për migrim dhe për t'u larguar nga vendi, në kërkim të një standardi më të mirë jetësor, mosbesimi ndaj institucioneve dhe partive politike është akoma në nivel të lartë dhe paragjykimet ndaj diversitetit edhe më tej janë rrënjësor thellë në qëndrimet. Hartuesit e politikave dhe vendimmarrësit, qytetarët, por edhe të rinjtë, duhet të ndikojnë mbi këto tendenca negative duke:

- Krijuar rrjetin formal për rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për pasojat që burojnë nga vjedhjet;
- monitorimin e vazhdueshëm të tendencave konfliktuale në komunitet dhe ndikimet të cilat zakonisht ndikojnë mbi qytetarët;
- rritjen e rolit të qytetarëve në kufizimin e akteve të dhunës;
- rritje bashkëpunimi për përcaktimin e pjesëmarrësve përmes identifikimit të shtrirjes së indikatorëve dhe zhvillimit të strategjisë së përbashkët për shkaqet e konfliktit;
- bashkëpunim me institucione fetare dhe ekonomike me qëllim të mobilizimit të kapaciteteve të tyre dhe përdorimi i ekspertizës gjatë promovimit të dëmit nga dhuna përmes organizimit të dialogut në një pjesë ose në tërë bashkësinë;
- identifikimin e mekanizmave tradicional për zgjidhjen e konflikteve, zhvillimin e mënyrave për përdorimin e tyre tanimë në situata të përshkallëzuara dhe prezenca e ekipeve konsulente dhe e eksperte të qytetarëve në zonat e konflikteve për shkak të përcaktimit të kërkesave të popullsisë lokale me qëllim të shmangies dhe ndërprerjes së dhunës;
- angazhimin e trajnuesve të cilët do të punojnë në parandalimin e konflikteve në shkolla;
- zhvillimin dhe trajnimin e agjencive lokale mediatike dhe të agjencive ndërkombëtare për informim dhe për publikimin e historive të suksesshme që kanë të bëjnë me mungesën e përdorimit të dhunës.

PËRFUNDIME

Dukuria e grabitjeve dhe vjedhjeve të rënda në Republikën e Maqedonisë Veriore mbetet një ndër sfidat kryesore të saj. Grabitjet dhe vjedhjet në përgjithësi si dukuri e cila dita ditës po ngulfat shoqërinë tonë, paraqet rrezik permanent për ekonominë dhe shoqërinë demokratike në përgjithësi.

Sa është e shprehur dukuria e grabitjeve dhe vjedhjeve të rënda në një shoqëri, pasqyron gjendjen shoqërore, politike dhe sigurinë nacionale të një shteti. Si e tillë ajo paraqet kërcënim edhe për sigurinë ndërkombëtare të një regjioni të caktuar të shteteve. Prandaj në të gjitha shtete bashkëkohore-demokratike ku mirëqenia e qytetarit është prioritet i politikës shtetërore, parandalimi dhe luftimi i dukurisë së grabitjeve dhe vjedhjeve të rënda është pjesë e strategjisë zhvillimore të çdo qeverie.

Duke pas parasysh që veprat penale të grabitjeve dhe vjedhjeve të rënda kanë të bëjnë me shkelje të dispozitave ligjore, kodit të etikës profesionale nga kryesit e veprës, me qëllim të përfitimit të paligjshëm të pasurisë apo të krijimit të benefiteve të caktuara për veti apo për personat e tjerë, dukuria e grabitjeve dhe vjedhjeve të rënda, paraqet shkelje të rendit kushtetues dhe të drejtat dhe lirive themelore të njeriut. Grabitjet dhe vjedhjet e rënda manifestohen në forma të ndryshme në një shoqëri, si: mossiguria shoqërore si pasojë e prishjes së rendit dhe qetësisë publike, mosbesimi shoqëror tek insitucionet përkatëse shtetërore që punojnë dhe janë të autorizuar na zbardhjen e këtyre veprave penale, paraqitja e aversionit ndaj policisë, prokurorisë dhe gjykatës në RMV, dhënie dhe marrje e ryshfetit, shantazhimi, etj. Prandaj, dukuria e grabitjeve dhe vjedhjeve të rënda shkakton pasoja e implikime të rënda e të mëdhaja sociale, politike, ekonomike dhe të sigurisë në përgjithësi. Grabitjet dhe vjedhjet e rënda, dëmtojnë rëndë kredibilitetin e një shteti, si brenda, ashtu edhe në arenën ndërkombëtare.

Një sfidë në vete paraqet edhe identifikimi i shkaqeve të grabitjeve dhe vjedhjeve të rënda me qëllim të parandalimit dhe luftimit sa më efikas të saj. Në luftimin e kësaj dukurie rol të rëndësishëm luajnë insitucionet gjyqësore, prokuroriale, entet sociale, sistemi arsimor, etj.

Të gjitha këta faktorë ndikojnë në parandalimin dhe luftimin sa më efikas të dukurisë së grabitjeve dhe vjedhjeve të rënda në shoqërinë e shtetit tonë.

Infrastruktura ligjore e Republikës së Maqedonisë Veriore, respektivisht dispozitat e Kodit Penal parashohin veprat penale të grabitjeve dhe vjedhjeve të rënda, mirëpo implementimi i tyre nuk është i kënaqshëm dhe i mjaftueshëm për parandalimin e kësaj dukurie kriminale nga ana e institucioneve të gjyqësisë dhe prokurorisë. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim duhet të luajnë edhe disa institucione me kompetenca administrative, siç janë Avokati i Popullit, Ministria e Punëve Sociale, respektivisht psikologët dhe pedagogët të punësuar në këtë ministri, etj.

Shoqëria maqedonase, institucionet shtetërore, shoqëria civile gjinden para një sfide e pagëzuar – grabitje dhe vjedhje të rënda. Kjo sfidë duhet të tejkalohet me qëllim që shteti i Republikës së Maqedonisë Veriore t'i plotësojë kriteret e kërkuara nga bashkësia ndërkombëtare për lëvizjen e lirë të popullatës në shtetet e Bashkësisë Evropiane, kusht i cili edhe më tej do të ashpërsohet në periudhën kur RMV seriozisht do të pretendoj për t'u integruar në Bashkësinë Evropiane, pas marrjes së rekomandimit në hapjen e negociatave për anëtarësim në BE.

Krimi i organizuar është një fenomen që manifestohet në të gjitha shtetet e botës. Pavarësisht formave të ndryshme të manifestimit, krimi i organizuar kudo që paraqitet ndikon në stabilitetin politik, rrezikon sistemin juridik, kërcënon sigurinë sociale dhe shkel të drejtat e njeriut. Një kërcënim dhe rrezikshmëri të tillë krimi i organizuar paraqitet edhe në shtetet e Ballkanit, kryesisht ato në tranzicion, siç janë vendet e Europës Juglindore. Këtij realiteti nuk i shpëton dot as Republika e Maqedonisë së Veriut. Në praktikë këto shtete duke e pranuar ekzistencën e krimit të organizuar në shoqëritë e tyre dhe duke e njohur rrezikun e tij, kanë ndëmarrë masa të navojshme në drejtim të krijimit të një legjislacioni të mirëfilltë, reformimit të institucioneve shtetërore dhe përmirësimit të bashkëpunimit mes institucioneve nacionale dhe atyre rajonale dhe ndërkombëtare me qëllim të luftimit efikas të tij.

Mirëpo edhe përkundër këtyre masave të ndërmarra dhe avancimit të luftës kundër krimit të organizuar në njërin nga prioritetet kryesore, format dhe përmasat e manifestimit të tij në

RMV, paraqesin rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe një tërësi nga pengesat kryesore në procesin e integritetit të këtij shteti në Bashkimin Evropian.

Është karakteristike se në Ballkan, konfliktet politike, kufijtë shtetërorë, regjimi i vizave dhe barrierat e ndryshme doganore nuk kanë shërbyer si pengesa për zhvillimin e krimit të organizuar ose vendosjen e bashkëpunimit në mes grupeve me përkatësi të ndryshme. Përkundrazi, konfliktet politike dhe kufijteshtetërorë në Ballkan deri më tani kanë shërbyer vetëm si pengesa për vendosjen e një bashkëpunimi efikas në mes shteteve të Ballkanit në luftë kundër krimit të organizuar, korrupsionit, pastrimit të parave, terrorizmit, vjedhjeve dhe formave tjera të veprimtarive kriminale.

Praktikat e deritanishme të luftës kundër krimit të organizuar, kanë dëshmuar se kjo luftë nuk mund të zhvillohet me suksesin e dëshiruar, vetëm përmes miratimit të ligjeve me standarde evropiane dhe reformimit të institucioneve për zbatimin e ligjit. Paraqitja e formave të reja të veprimit të krimit të organizuar, imponon nevojën përkrijimin e institucioneve tëspecializuara të policisë, prokurorisë dhe gjykatave, sipas praktikave të dëshmuara evropiane dhe arsimimin e tyre të vazhdueshëm me njohuri të reja kriminalistike, juridike, ekonomike, bankare, finansiare, njohuri në fushën e auditimit etj.

Lufta kundër krimit të organizuar dhe shmangies së vjedhjeve nuk duhet parë dhe kuptuar vetëm si detyrë, ose përgjegjësi e shtetit. Vendosja e formave të ndryshme të bashkëpunimit midis aktorëve të ndryshëm nacional dhe ndërkombëtar është elementi kryesor që përcakton suksesin e kësaj lufte. Prandaj bashkëpunimi mes shteteve të rajonit, duhet zhvilluar sipas detyrimeve që rrjedhin nga Konventat e ndryshme, për të cilat folëm në këtë punim.

Përderisa krimi i vjedhjeve të rënda përmbledh në vetvete shumë aspekte të veprimtarisë kriminale, atëherë edhe RMV, duhet qëpërmes vlerësimit të gjëndjes faktike, identifikimit të problemeve dhe veprimeve të përbashkëta mund të ndikoj në ndërtimin e një politike të përgjithshme parandaluese, në një shteti cili aspiron anëtarësimin e shpejtë në strukturat e BE-së.

BIBLIOGRAFIA

a) Libra:

1. Abadinsky, H., Organized Crime, Belmont, 2009;
2. Arnaudovski, Lj., Kriminologija, Shkup, 2007;

3. Elezi, E., Efektiviteti i Legjislacionit dhe Sistemit të Drejtësisë Penale kundër Kriminalitetit në Procesin e Intergrimit Evropian, Tiranë, 2015;
4. Elezi, I., E Drejta Penale – Pjesa e Posaçme, Tiranë, 2018;
5. Gashi, R., Krimi i Organizuar, Prishtinë;
6. Halili, R., Kriminologjia, Prishtinë, 2016;
7. Hysi, V., Kriminologjia, Tiranë, 2011;
8. Kambovski, V. & Zeneli, I., E Drejta Penale – Pjesa e përgjithshme, Tetovë;
9. Lajman, M. & Poter, G., Organiziran Kriminal, Shkup, 2009;
10. Latifi, V. & Beka, A., Taktika Kriminalistike, Prishtinë, 2017;
11. Latifi, V. & Beka, A., Vrasjet, Krimi i Organizuar, Terrorizmi – Zbulimi dhe të Provuarit, Prishtinë, 2013;
12. Latifi, V. & Elezi, I. & Hysi, V., Politika e Luftimit të Kriminalitetit, Prishtinë;
13. Latifi, V., Kriminalistika – Zbulimi dhe të Provuarit e krimit, Prishtinë, 2014;
14. Sacić, Z., Organizirani kriminal – Metode suzbijanja, Zagreb, 2001;
15. Sahiti, E. & Zejneli, I., E Drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Tetovë, 2004;
16. Vodinelic, V., Kriminalitika, Beograd, 1996;
17. Zejneli, I., E Drejta Penale, - Pjesa e posaçme, Tetove, 2007;
18. L., Vesel, Kriminalistika e delikuencës së të miturve;
19. K., Vllado, “E drejta penale”, pjesa e përgjithshme;
20. L., Vesel, Kriminalistika e delikuencës së të miturve;
21. Angeleski, M. Operativna kriminalistika, Shkup 2005;
22. Angeleski, M., Stojanovski, D., Simonovic, B. Kriminalisticka tehnika;

23. Koteski, M. Kriminalisticka taktika, Fakultet za bezbednost, Shkup 2010;
24. Koteski, M., Nikolovski, M. Meodika na istazhuvanje na opsht kriminalitet, 2008;
25. Zerjav, C. Kriminalistika , Zagreb 1986;
26. Meihner, F. Kriminal taktik , Hamburg, 1954;
27. Roso, Z. Informativni razgovor I intervju, Zagreb 1988;
28. From, E. Anatomia e destruktivititetit njerezor, Zagreb 1975;
29. Krivokapic, B. Prevencioni i kriminalitetit, Beograd 2002;
30. Sulejmanov, Z.,. Kriminologija, Skopje. 2003;
31. Gashi, R., “Krimi i Organizuar” (ligjerata te autorizuar) Prishtinë 2011;
32. Latifi, V., “Politika Kriminale”, Prishtinë, 1998;
33. Saliu, I., “E drejta penale”(pjesë e përgjithshme), Prishtinë, 2005;

b) Aktet ligjore:

1. Kodi (Ligji) Penal dhe Kodi (Ligji) i Procedurës Penale të: Republikës së Maqedonisë të Veriut;
2. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Maqedonisë të Veriut;
3. Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë të Veriut;
4. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë të Veriut;
5. Ligji i punëve të brendshme i RMV;
6. Ligji i policisë në RMV;
7. Kodi penal për të miturit;
8. Ligji i së drejtës së miturve;

9. Ligji për mbrojtjen e informatorëve;
10. Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve;
11. Ligji për mbrojtje sociale në RMV;

c) Burime tjetra:

1. Deklarata e Vjenës për Krimin dhe Drejtësinë, Rezoluta 55/9 – 2000 –OKB-së;
2. Konventa e Bashkëpunimit Policor në Evropën Juglindore – 2 Tetor 2018;
3. Konventa SELEC(Qendra e Forcave të Ligjit të Evropës Juglindore);
4. Konventa për Bashkëpunim Policor në Europën Juglindore (Konventa e Vjenës);
5. SELEC(Qendra e Forcave të Ligjit të Evropës Juglindore);
6. Amnesty International: *Trafficked Women and Girls have Human Rights*, 2004;
- 7 . Department of Crime Problems: *Organised crime situation report 2005, Focus on the threat of economic crime. Council of Europe*. Strasbourg, December 2005;
8. Detlef Briesen: *Drogenkonsum und Drogenpolitik in Deutschland und der USA. Ein historischer Vergleich*, Campus Verlag, 2005, Frankfurt am Main;
9. Eric Hobsbawm: *Nationen und Nationalismus. Mythos und Realität seit 1780*, Campus Verlag, 2005;
10. European Parliament's Committee on Civil Liberties, Justice and Home Affairs: *Europe's Crime-Terror Nexus*;
11. European School Survey Project on Alcohol and other Drugs, UNODC Programme for South Eastern Europe and Paris Pact Initiative, *Drug Situation Analysis Report*, Paris 2011;
12. Europol Jahresbericht 2011;
13. Europol Socta 2013, *EU Serious and Organised Crime Threat Assessment*, European Police Office, 2013;

14. Qaja, E.,: *Stigmatizimi dhe politikat anti – drogë në Shqipëri*,
15. Gazeta “Jeta në Kosovë”, Shtator 2012, “Milion Euro Dëm Nga “Zona Gri” e Veriut”;
16. Komisioni Evropian, Projekti Rajonal CARPO, Raporti mbi Gjendjen e Krimit të Organizuar dhe Krimit Ekonomik në Evropën Juglindore, Stassburg 2006;
17. Konrad Cleeing, Oliver Jens Schmitt: *Geschichte Südosteuropas*. Verlag Friedrich Pustet, Regensburg 2012;
18. Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit (UNCAC);
19. Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (UNTOC);
20. Konventa për Bashkëpunim Policor për Evropën Juglindore, Vjenë 5 maj 2006,
21. Legjislacioni dhe praktikat e rajonit në luftimin e krimit të organizuar dhe pasurisë së paligjshme, Instituti Demokratik i Kosovës, Prishtinë 2011;
22. Lindstrom, Nicole: *Regional Sex Trafficking in the Balkans. Transnational Networks in an Enlarged Europe*, in: Problems of Post-communism (Volume 51, Number 3) M. E. Sharp, USA, 2004;
23. Manuela Riedeland, Marnix Eichelberg: Bashkëpunimi rajonal në Evropën Juglindore – Periudha pas Paktit të Stabilitetit, Programi për politikë të jashtme dhe siguri, 2009 Shkup;
24. Mapo Online, Raporti: Grupet shqiptare, rol kyç në trafukun e heroinës, bashkë me turqit;
25. Okey, Robin (2007). *Taming Balkan Nationalism*. Oxford ; New York : Oxford University Press, 2007;
26. Gazeta “Rajoni Press”, “Kontrabanduesve të armëve”;
27. Richard Kauzlarich, ish ambasadori amerikan në Bosnje në vitin 1990, Black Sea and Caspian Sea Symposium 9-10 March 2006, National Defense Intelligence College Washington, DC;
28. Riegler, Henriette, Austrian Institute for International Affairs (OIIP);

29. Riegler, Henriette, *Contextualizing Criminality and Security in South Eastern Europe*, in: Connections (Volume II, Number 2), Partnership for Peace Consortium of Defense Academies and Security Studies Institutes;
30. Robert Hislope: *Qetësi para stuhisë?Ndikimi i rrjeteve ndërkufitare, korrupsionit dhe kontrabandës mbi stabilitetin e Maqedonisë dhe sigurinë në rajon*, Union College;
31. Strategjia Kombëtare kundër Drogës, 2012-2016, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Nr. 85, Tiranë, korrik 2012;
32. Strategjia lokale dhe Plani aksional për droga në Qytetin e Shkupit 2008 – 2013, Shkup 2008;
33. United Nations Office on Drugs and Crime (UNODC), Vienna, Heroin 5;
34. United Nations Office on Drugs and Crime (UNODC/ Zyrrave e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin), Trafikimi i qenieve njerëzore: Manual për bashkëpunimin ndërkombëtar;
35. United Nations Office on Drugs and Crime (UNODC), Transnational Organized Crime Threat Assessment (TOCTA);
36. United Nations Office on Drugs and Crime (UNODC), *World Drug Report 2011*;
37. Vera Stojarova (u.a). Organized Crime in the **E**astern Balkans. HUMSEC Journal Issue;
38. Zoran Daskalović: *Corruption and Organized Crime. Croatia: Crime and Corruption Continue.*